



PROPOZIM
I ORGANIZATAVE
QYTETARE
**PËR REFORMA
URGJENTE
DEMOKRATIKE**

PROPOZIM
I ORGANIZATAVE
QYTETARE
PËR REFORMA
URGJENTE
DEMOKRATIKE

Shkup, korrik 2017

PËRMBAJTJE

| | |
|--|------------|
| HYRJE | 5 |
| QASJA | 6 |
| PËRFSHIRJA, MONITORIMI DHE VLERËSIMI | 8 |
| FUSHAT, PRIORITETET, MASAT, INSTITUCIONET KOMPETENTE DHE AFATET | 10 |
| FINANCAT PUBLIKE DHE EKONOMIA | 10 |
| GJYQËSORI | 14 |
| LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT | 19 |
| ZGJEDHJE DHE SISTEMI ZGJEDHOR | 26 |
| ADMINISTRATA PUBLIKE | 29 |
| KONTROLLI MBI POLICINË DHE AGJENCITË PËR SIGURI DHE (KUNDËR)ZBULIM | 35 |
| KUVENDI | 42 |
| SHOQËRIA QYTETARE | 55 |
| MBROJTJA SOCIALE, MIRËQENIA DHE QËNDRUESHMËRIA | 62 |
| ARSIMI DHE POLITIKAT RINORE | 67 |
| MJEDISI JETËSOR | 75 |
| ENERGJETIKA | 79 |
| KULTURË | 83 |
| SHËNDETËSI | 89 |
| LISTA E SHKURTESAVE TË PËRDORURA | 97 |
| SHTOJCA 1 - LISTA E ORGANIZATAVE DHE EKSPERTËVE TË PËRFSHIRË NË INOVACIONIN | 101 |

HYRJE

Ky dokument paraqet **plotësim** i “Propozimit për reforma urgjente demokratike” përgatitur nga një grup të organizatave qytetare dhe ekspertëve në fillim të korrikut të vitit 2016.¹

Qëllimi original i dokumentit mbetet i njëjtë, gjegjësisht ai duhet të “nxit, jep drejtime dhe aktivitete në detaje që janë të nevojshme për kthim të standardeve dhe vlerave demokratike, për përparim në fusha të caktuara të politikave publike, si dhe për kthim të besimit të qytetarëve në institucionet kyçe qeveritare”. Ndryshimi i pushtetit, në vete, ishte hap përpara pasi që me mbajtjen e zgjedhjeve të besueshme u përfundua kriza shumëvjeçare politike, por kjo nuk është garanci për reforma sistematike që janë të nevojshme për të tejkaluar gjendjen e *shtetit të zënë*.

Ky ndërhyrje e përbashkët është përgjigje e situatës së ndryshuar politike, gjegjësisht formimit të qeverisë së re që ka shprehur gatishmëri që të punon për reforma demokratike në vend. Me këtë dokument, grupi i përfshirë i organizatave qytetare dhe ekspertëve ka dhënë mendimin e vet mbi prioritetet dhe masat që duhet të drejtojnë programin qeveritar në 12 muajt e ardhshëm.

Fushat e politikave publike të përpunuara në dokument janë: financa publike dhe ekonomi; gjyqësori; lufta kundër korrupsionit; zgjedhje dhe sistemi zgjedhor; administrata publike; kontrolli mbi policinë dhe agjencitë për sigurim dhe (kundër)zbulim; Kuvendi; shoqëria qytetare; mbrojtja sociale; mirëqenia dhe qëndrueshmëria; arsimi i dhe politikat rinore; mjedisi jetësor; energjetika; kultura dhe shëndeti.²

Ky dokument është përgatitur në bazë të përvojës dhe ekspertizës shumëvjeçare në fushat përkatëse të intervenimit. Pjesë e madhe e instrumenteve dhe masave janë pjesë e angazhimeve, raporteve dhe rekomandimeve të propozuara nga shoqëria qytetare në fushat përkatëse.

1 Lista e organizatave dhe ekspertëve të përfshirë në përgatitjen e dy dokumenteve është në Shtojcën 1: Lista e organizatave dhe ekspertëve të përfshirë në iniciativën

2 Dy fushat e fundit nuk janë përfshirë në dokumentin origjinal dhe për to janë përdorur materiale nga iniciativa komplementare

QASJA

Në përgatitjen e përmbajtjeve në fushat e politikave publike të prezantuar në këtë dokument kanë marr pjesë 146 përfaqësues prej 73 organizatave, punëtorë shkencor dhe ekspertë të pavarur që kanë dhënë kontributin e tyre në grupet e punës në forumin “Propozim i organizatave qytetare për reforma urgjente demokratike” që u mbajt me 4 dhe 5 korrik të vitit 2017 në Shkup. Iniciatorët dhe organizatorët e forumit ishin organizatat e bërthamës së iniciativës “Propozim për reforma urgjente demokratike” prej qershor të vitit 2016, që gjatë vitit të kalua kanë konsultuar për fushat përkatëse me palë tjera të prekura.

Secila nga fushat është prezantuar nëpërmjet një përmbledhjes dhe matricës së shkurtër të fushave dhe masave prioritare të propozuara për 12 muajt vijues, me afate të përcaktuara në nivel tremujor (3,6,9 dhe 12 muaj) dhe me institucione kompetente qartë të përcaktuara. Për masat në fushat ku organizatat dhe ekspertët nuk mundeshin të arrijnë mendime të përbashkëta, janë ofruar opsione për politika publike me të cilat do mund të veprohet.

Gjatë përcaktimit të prioriteteve dhe masave është marr parasysh dinamika e hapave reformues, në përputhje me kornizën kohore të imponuar nga afatet për përparim në procesin për fitim të rekomandimit për nisje të negociatave për anëtarësim në Bashkimin evropian. Organizatat qytetare dhe ekspertët e përfshirë në përgatitjen e këtij dokumenti pritnin se vullneti i shprehur për reforma nga ana e Qeverisë së re do të realizohet me plotësimin e numrin më të madh të rekomandimeve të përmbajtura në këtë dokument. Në fushat ku kjo nuk do të ndodh, presim nga Qeveria dhe nga bartësit e vendimeve të arsyetojnë qasjen e tyre dhe shkaqet për përzgjedhjen e zgjedhjeve të ndryshme. Zgjedhjet që janë pjesë e këtij dokumenti paraqesin vendosmëri për ballafaqim me problemet e grumbulluara në institucionet publike.

Gjatë gjithë këtij procesi Qeveria duhet të respekton parimet e transparencës, përgjegjshmërisë, përfshirjes dhe efektivitetit.

Është e domosdoshme që partitë politike në Kuvendin e RM të tregojnë përkushtim të vërtet për zbatimin e prioriteteve kyçe reformatore. Përkushtimi i tillë pritet edhe nga partitë jashtëparlamentare, si dhe nga shoqëria qytetare në tërësi.

Përskaj kësaj, edhe institucionet kompetente në pushtetin gjyqësor, si dhe organet e pavarura mbikëqyrëse dhe rregullatore, duhet të tregojnë përkushtimin e tyre për zbatim të prioriteteve kyçe reformatore.

Gjithashtu, është e domosdoshme që masat e ndërmarra të drejtohen kah përmirësimi i kohezionit social të qytetarëve dhe të gjitha bashkësive etnike. Në këtë dre-

jtim, duhet të shqyrtohen rekomandimet nga Shqyrtimi i Marrëveshjes kornizë të Ohrit për kohezion social nga viti 2015.³

Gjatë krijimit dhe zbatimit të politikave, është e domosdoshme që të merret parasysh respektimi i çështjeve horizontale, veçanërisht barazisë gjinore, përfshirjes së të rinjve, personave me nevoja të posaçme dhe bashkësive tjera të marginalizuara.

3 Në dispozicion në: <http://www.siofa.gov.mk>

PËRFSHIRJA, MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Për zbatim të plotë të këtyre reformave nevojitet vlerësim i mëparshëm i situatës, i cili do të bazohet në të dhëna zyrtare dhe reale në secilën prej fushave që janë lëndë e dokumentit. Kyçe është që sektori qytetar të përfshihet në procesin e vlerësimit të situatës së tanishme, si dhe në monitorimin dhe vlerësimin e përparimit në zbatimin e prioritetëve kyçe reformatore.

Duhet të sigurohet pjesëmarrja qytetare edhe në nivel të pushtetit ekzekutiv, si dhe në nivel të pushtetit ligjvënës, përfshirë bashkëpunimin me gjyqësorin dhe me organet e pavarura, kontrolluese dhe rregullatore. Në këtë drejtim propozojmë:

- Formimin e Këshillit konsultativ për zbatim të prioritetëve kyçe reformatore në nivel qeveritar, me të cilën do të kryeson kryetari i Qeverisë dhe i cili do të përbëhet prej përfaqësuesve të ministrive kompetente dhe shoqërisë qytetare. Në kuadër të këtij Këshilli duhet të formohen grupe tematike të organizatave qytetare, shoqata jorformale qytetare, think-tanke, iniciativa joformale, sindikate, etj., me qëllim që të përkrahen konsultimet, monitorimi dhe vlerësimi i prioritetëve kyçe reformatore;
- Emërtim i personave për kontakt në ministrinë dhe në organet e pavarura, mbikëqyrëse dhe rregullatore, që do të jenë përgjegjëse për prioritetet kyçe reformatore dhe që do të jenë përgjegjëse për bashkëpunimin me grupet tematike të shoqërisë qytetare;
- Organet kompetente të kuvendit duhet të mbajnë seanca publike mujore për zbatim të prioritetëve kyçe reformatore që janë në kompetencat e tyre. Në këto seanca duhet të ftohen përfaqësues të shoqërisë qytetare me përvojë të madhe në fushat përkatëse. Ky aktivitet përfshin komisionet vijuese (lista nuk është e plotë):
 - ♦ Komisioni për sistem politik dhe marrëdhënie mes bashkësive;
 - ♦ Komisioni për financa dhe buxhet;
 - ♦ Komisioni për transport, lidhje dhe ekologji;
 - ♦ Komisioni i përhershëm anketues për mbrojtje të lirive dhe të drejtave të qytetarit;
 - ♦ Komisioni për mbikëqyrje të punës së Drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim dhe të Agjencisë për zbulim;
 - ♦ Komisioni për mbikëqyrje të zbatimit të masës së posaçme hulumtuese ndjekje të komunikimeve nga Ministria e punëve të brendshme, Drejtorisë për polici financiare, Drejtorisë doganore dhe ministrisë për mbrojtje;
 - ♦ komisionet tjera kompetente;

Përkaj kësaj, Këshilli kombëtar për eurointegrim, si dhe Komisioni për çështje evropiane, duhet të mbajnë seanca mujore përkushtuar zbatimit të prioriteteve kyçe reformatore, në bazë të raporteve të dorëzuara nga Qeveria dhe nga organet e pa-varura, mbikëqyrëse dhe rregullatore dhe mbi diskutimet në komisionet amë të kuvendit.

Organizatave qytetare që kanë marr pjesë në përgatitjen e këtij dokumenti do të angazhohen dhe do të kontribuojnë në diskutimin e mëtutjeshëm mbi mënyrat e përfshirjes së shoqërisë qytetare në proces.

FUSHAT, PRIORITETET, MASAT, INSTITUCIONET KOMPETENTE DHE AFATET

FINANCAT PUBLIKE DHE EKONOMIA

Nevojitet transparencë më e madhe në financat publike, që duhet të sjell llogaridhënie mbi atë se si planifikohen dhe shpenzohen resurset publike të shtetit. Transparenca publike u gërrye, kurse elitat proqeveritare kishin bllokuar burimet më të bujshme për prodhim dhe për rishpërndarje të mirëqenies, me çfarë Qeveria ishte e detyruar të merr hua që të plotëson kërkesat e klientëve të saj. Kjo solli në ad-hok miratimin e vendimeve financiare jashtë procesit buxhetor dhe në rrënimin e kredibilitetit e institucioneve mbikëqyrëse të ciklit buxhetor dhe në përgjithësi, në disiplinë të zvogëluar buxhetore.

Parimet e përgjithshme për aktivitetet e propozuara janë këto: rritje e disiplinës fiskale dhe qëndrueshmërisë; përforcimi i transparencës fiskale; llogaridhënie dhe pjesëmarrësi; përmirësim i efikasitetit dhe efektivitetit, mbikëqyrjes dhe përgjegjësisë së financave publike.

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|---|--|-----------------------------|--------------|
| 1. | Transparenca fiskale, llogaridhënie dhe pjesëmarrësia | <ul style="list-style-type: none"> Publikimi i planeve mujore buxhetore dhe raporteve për zbatim të buxhetit dhe të gjithë përdoruesve buxhetor. Këto plane dhe raporte duhet të jenë më analitik në kuptim të nënpikës (gjashtë shifra) sipas klasifikimit ekonomik dhe sipas përdoruesit buxhetor edhe në format të hapur. Largimi i pikës 23, gjegjësisht 22 prej Udhëzimit për mënyrën e punës së thesarit, gjegjësisht Udhëzimin për mënyrën e punës së FSSH. | Ministria e financave (MF) | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Publikim transparent të detyrimeve që duhet paguar, por nuk janë paguar më gjatë se tre muaj, gjithsej he sipas përdoruesve buxhetor. | MF | 3 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|-----------|---|--|--------------|
| | | <ul style="list-style-type: none"> Vlerësimi i projekteve kapitale të Qeverisë dhe shpallja e strukturës së tyre sipas fazës së zbatimit (planifikimi, faza aktuale dhe faza përfundimtare). Duhet t'ju jepet përparësi atyre projekteve që për shkak të natyrës dhe/ose qëllimit të tyre nuk mund të ndalën. | MF | 6 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Shpërbërja e Këshillit për furnizime publike; vlerësim i zbatimit të furnizimeve publike dhe ndërprirje të praktikës së zbatimit të furnizimeve publike dhe dhënien e kontratave vetëm sipas kritereve financiare (çmimi më i ulët). | MF, Qeveria e Republikës së Maqedonisë (Qeveria), Kuvendi i RM (Kuvendi) | 12 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Publikimi i numrit të të punësuarve në sektorin publik edhe për vitet e kaluara. | MF, Ministria për shoqëri informatike dhe administratë (MShIA) | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Vlerësimi i politikës së deritanishme tatimore dhe publikimi i efekteve të pritura nga politika e re tatimore e Qeverisë së re. | MF | 6 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Themelimi i komisionit kuvendor për shqyrtim të raporteve të Entit shtetëror për revizion, gjegjësisht mbikëqyrje të shpenzimeve publike. | MF, Kuvendi | 12 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Shqyrtim i detyrueshëm i Raportit vjetor për funksionim të sistemit për kontroll të brendshëm financiar në Komisionin për financim dhe buxhet, gjegjësisht në Komisionin për shqyrtim të raporteve të Entit shtetëror për revizion, ose mbikëqyrje të shpenzimeve publike (nëse janë bazë). Raport vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar të publikohet në tërësi në ueb faqen e Ministrisë për financa, përfshirë edhe raportet individuale nga Raporti vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar. | MF | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Vlerësim dhe rishikim i kalendarit buxhetor me qëllim që të sigurohet fleksibilitet më të madh, transparencë dhe pjesëmarrësi. | MF | 6 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|-----------|---|--|---|--------------|
| | | <ul style="list-style-type: none"> • Transparencë më e madhe në ndarjen Ministri e financave – funksione të shtetit, me zhdukjen e saj të tërësishe në të ardhmen. | MF | 12 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> • Dorëzim i kohëshëm i Strategjisë fiskale tek Kuvendi i RM në fillim të procesit buxhetor, me qëllim që të kontribuohet për përgatitje më të mirë të deputetëve për shqyrtim të pjesës financiare të propozim-buxhetit në fazën e miratimit. • Përgatitja e detyrueshme e deklaratës parabuxhetore (në veçanti ose si pjesë e Strategjisë fiskale) e cila duhet të përmban të gjitha qëllimet afatgjate ekonomike, fiskale dhe të tjera të qeverisë për buxhetin e ardhshëm, edhe atë së paku për tre vitet vijuese fiskale. | MF | 12 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> • Përgatitje e detyrueshme e Buxhetit qytetar në nivel qendror dhe në nivel të njësisë të vetëqeverisjes lokale (NjVL). | MF, NjVL | 9 |
| 2. | Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit, mbikëqyrjes dhe përgjegjësisë për financa publike | <ul style="list-style-type: none"> • Ministri i financave në mënyrë transparente të përgatit dhe të publikon qëllimet, përdorimin dhe kushtet për secilën hua, grant ose donacion. | MF | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësim dhe publikim i implikacioneve buxhetore nga projekti “Shkupi 2014” sipas vitit, strukturës, konstruksionit financiar dhe mjeteve të shpërndara. | MF | 9 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> • Shpallja e të dhënave nga të gjitha grupet dhe nëngrupet që janë instrumente të ndihmës shtetërore, edhe atë: ndihmë shtetërore e planifikuar, realizuar dhe miratuar, sipas dhënësit të ndihmës shtetërore dhe sipas qëllimit të ndihmës shtetërore, në vitet e mëparshme dhe vazhdimisht (në format të hapur). | MF, Ministria për ekonomi (ME), Kuvendi | 9 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|-----------|---|--|--|--------------|
| | | <ul style="list-style-type: none"> Të hulumtohet mundësia që Prokuroria publike, Ministria për punë të brendshme dhe Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit rregullisht të njoftojnë mbi procedurat e nisura sipas gjetjeve dhe raporteve të Entit shtetëror për revizion dhe publikut. | MF, Enti shtetëror për revizion, Prokuroria publike, Ministria për punë të brendshme (MPB), Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit | 9 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Formimi i Këshillit fiskal, si institucion i ri në sistemin e financave publike i cili do të shërben si ex-ante vlerësim për arsyeshmërinë e politikës fiskale të pushtetit ekzekutiv. | Kuvendi | 6 |
| 3. | Rritja e disiplinës dhe qëndrueshmërisë fiskale | <ul style="list-style-type: none"> Pagesa joselektive e shpenzimeve aktuale dhe themelimi i parimit kronologjik për pagim të detyrimeve të arritura (pagesa e kohës dhe detyrimeve). | MF | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Publikimi i rregullt i strukturës së borxhit publik, përfshirë edhe detyrimet e papaguara dhe borxhet e njësisë të vetëqeverisjes lokale, ndërmarrjeve publike, Bankës Maqedonase për përkrahje dhe zhvillim, edhe atë për së pak tre vjet pas. | MF | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Vlerësimi i shpenzimeve dhe përfitimeve nga investimet e huaja të drejtpërdrejta, si dhe aktivitetet e lidhura me tërheqjen e investimeve të huaja të drejtpërdrejta. | MF, ME | 9 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Vlerësim i qëndrueshmërisë dhe transparencës së subvencioneve bujqësore, me theks të posaçëm mbi shpërndarjen e tyre; publikim transparent dhe të rregullt të lartësisë së përkrahjes së dhënë sipas përdoruesit dhe masës, në formë të të dhënave të hapura. | MF, Ministria për Bujqësi, pylltari dhe ekonomi të ujit, Agjencia për përkrahje financiare të bujqësisë dhe zhvillimit rural | 9 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Vlerësim i kapacitetit fiskal dhe qëndrueshmërisë së sistemit pensional, përfshirë edhe punën e MAPAS-it. | MF | 9 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Vlerësim i qëndrueshmërisë, transparencës dhe efekteve shpërndarëse nga transferet sociale. | MF, Ministria e punës dhe politikës sociale | 9 |

GJYQËSORI

Matrica e propozuar e prioriteteve, masave dhe aktiviteteve mbulon çështjet në fushën e gjyqësorit që kërkojnë trajtim urgjent nëpërmjet masave dhe hapave konkrete dhe afatshkurta dhe ndërmarrja e të cilëve nuk paraqet vështirësi më të rënda praktike. Njëkohësisht, kjo përfshin edhe qëllime prioritare që nënkuptojnë intervenime serioze ligjore dhe reforma institucionale me karakter sistematik dhe strategjik, për zbatimin e të cilëve nevojitet doemos përgatitje e konsiderueshme.

Dokumenti nuk i përfshin vetëm masat që duhet të ndërmerren në drejtim të sigurimit të drejtësisë efikase dhe procesim të rasteve që kërkojnë veprim urgjent për shkak të praktikës së mosndëshkueshmërisë, si dhe masat që duhet të mundësojnë reforma të thella të gjyqësorit, por edhe ato masa dhe aktivitete që duhet të kontribuojnë për mbrojtje më efikase gjyqësore të të drejtave dhe lirive nga aspekti i realizimit të tyre me çfarë do të kthehet besueshmëria e humbur e institucioneve gjyqësore mes qytetarëve.

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|---|---|--|--|
| 1. | Miratimi i Strategjisë për reforma të gjyqësorit | <ul style="list-style-type: none"> Propozim – strategji, përpiluar në përputhje me rekomandimet e Komisionit Evropian (KE), Komisionit të Venedikut dhe GREKO. | Ministria e drejtësisë (MD) – proces përfshirës (përfshirje aktive e ekspertëve të jashtëm dhe sektorit qytetar) | 3+3 (dërgim i propozim versionit të KE në tetor 2017, përfshirje të vërejtjeve të marra në procesin e këshillimit me KE gjatë dhjetorit të 2017) |
| 2. | Përgatitja e Planit të veprimit për zbatim të Strategjisë për reforma të gjyqësorit | <ul style="list-style-type: none"> Plani i parë i veprimit. | MD | 6 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|---|---|---|--------------|
| 3. | Formimi i grupit për rishqyrtim, rishikim ose tërheqje të Ligjit për mbrojtje të privatësisë | <ul style="list-style-type: none"> Propozim – ndryshime ligjore. | MD (pas debatit publik paraprakisht të organizuar me përfshirje të plotë të ekspertëve dhe të sektorit qytetar) | 3 |
| 4. | Tërheqja e Ligjit për Këshillin për përcaktim të fakteve dhe për nisje të procedurës për përcaktim të fakteve dhe nisje të procedurës për përcaktim të përgjegjësisë për gjykatës | <ul style="list-style-type: none"> Propozim – ligji për tërheqje. | Kuvendi i RM (Kuvendi) | 3 |
| 5. | Përforcimi i pavarësisë së Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë | <ul style="list-style-type: none"> Propozim – ndryshime në Ligjin për Këshill gjyqësor, në drejtim të marrjes së kompetencave nga Këshilli për përcaktim të fakteve dhe dyshkallësia e procedurës (ndarja e nisjes së procedurës dhe vendimmarrjes). | MD, Kuvendi | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Shkarkimi i anëtarëve të përhershëm të Këshillit gjyqësor, pas përcaktimit të mëparshëm nëpërmjet ndryshimeve në Ligjin për Këshill gjyqësor, në lidhje me bazat dhe procedurat për ndërprirje të funksionit dhe shkarkim të anëtarit të Këshillit, në përputhje me nenin 104, paragrafin 9 të Kushtetutës së RM. | MD, Kuvendi | 3 |
| 6. | Përforcimi i pavarësisë së Këshillit të prokurorëve publik | <ul style="list-style-type: none"> Përcaktimi i masave pas debatit të mëparshëm publik me përfshirje të ekspertëve, prokurorëve dhe të sektorit qytetar. | MD | 3 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|---|---|-----------------------------------|--------------|
| 7. | Themelimi i modelit të ri të Këshillit gjyqësor në drejtim të deprofesionalizimit të anëtarëve të tij dhe mundësi që ato të vazhdojnë të kryejnë obligimet gjyqësore, gjegjësisht të kryejnë punën e vete si profesionist në fusha të caktuara në profesionin e drejtësisë. | <ul style="list-style-type: none"> Këshillime me ekspertë, debat publik dhe aktivitete tjera në drejtim të gjetjes së modelit më të përshtatshëm të Këshillit gjyqësor. | MD | 9-12 |
| 8. | Përforcim i kriterëve vetëm më të themelura për emërtim të anëtarëve në Këshillin e prokurorëve publik nga ana e Kuvendit (katër anëtar) nga ana e "juristëve të dalluar" | <ul style="list-style-type: none"> Këshillime me ekspertë, debate publike dhe aktivitete tjera në drejtim të precizimit të mëtutjeshëm të kriterëve për zgjedhje të anëtarëve të Këshillit për prokuror publik, sipas shembullit të kriterëve për zgjedhje të anëtarëve të Këshillit gjyqësor. | MD | 9 |
| 9. | Tërheqja e Ligjit për përcaktimin e llojit dhe matjes së lartësisë së dënimit | <ul style="list-style-type: none"> Propozim-ligj për tërheqje të Ligjit. | Kuvendi | 3 |
| 10. | Përforcim i modelit të mbikëqyrjes dhe kontrollit të funksionimit dhe zbatimit të AKMIS | <ul style="list-style-type: none"> Ndryshimet dhe plotësimet e Rregullores së Gjykatës dhe Rregullores së Gjykatës Supreme. | MD dhe Gjykata Supreme | 3 |
| 11. | Themelim i departamentit të specializuar gjyqësor në kuadër të Gjykatës themelore Shkup 1 që do të vepron për lëndët e Prokurorisë Speciale Publike (PSP) | <ul style="list-style-type: none"> Vendim i Kryetarit të Gjykatës Themelore Shkup 1 – Shkup. | Gjykata Themelore Shkup 1 – Shkup | 3 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|---|---|--|--------------|
| 12. | Vazhdim i afatit për ngritje të mëtutjeshme të aktakuzave tek PSP për lëndët që rrjedhin nga përmbajtja e ndjekjes së paligjshme të telekomunikimeve | <ul style="list-style-type: none"> Formimi i organit ose departamentit të posaçëm në kuadër të Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë (PPRM) ose Prokurorisë Themelore Publike (PThP) për ndjekje të krimit të organizuar dhe korrupsionit (në përputhje me PSP, në mënyrë të paraparë me nenin 6, paragrafin 5 të Ligjit për Prokurori publike). | PPRM (menjëherë pas zgjedhjes së prokurorit të ri) | 3 |
| 13. | Mundësimi i qasjes së papenguar ndaj materialeve sipas kërkesave të PSP | <ul style="list-style-type: none"> Formimi i departamentit të posaçëm / emërtimi i personave për kontakt (focal points) brenda Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim (DSK) ose ndërmarrja e hapave dhe aktiviteteve të koordinuara në këtë drejtim nga ana e ministrit për punë të brendshme dhe drejtorit të DSZ. | Ministria për punë të brendshme (MPB), Drejtor i DSZ | 3 |
| 14. | Ndryshime dhe plotësime të Ligjit për mbrojtje të dëshmitarëve | <ul style="list-style-type: none"> Propozim-ndryshime dhe plotësime të Ligjit. | MD | 3 |
| 15. | Zbatim i qëndrueshëm i shumës procentuale të buxhetit të paraparë me ligj për Këshillin gjyqësor buxhetor | <ul style="list-style-type: none"> Organizim i debateve publike për buxhetin, me pjesëmarrje të ekspertëve dhe përfaqësuesve të sektorit qytetar. | Këshilli gjyqësor | 6 |
| 16. | Rivlerësim (rinotim) i bartësve të funksioneve gjyqësore, përfshirë edhe anëtarëve të përhershëm | <ul style="list-style-type: none"> Formimi i grupit të punës që do të propozon modelin dhe metodologjinë për rinotim (rivlerësim) të bartësve të funksioneve gjyqësore. | MD | 6 |
| 17. | Themelimi i modelit të rinotimit të bartësve të funksioneve gjyqësore, përfshirë edhe anëtarëve të përhershëm të Këshillit gjyqësor dhe Këshillit të prokurorëve publik | <ul style="list-style-type: none"> Aktivitete përgatitore për themelimin e modelit të ri të vlerësimit. | MD | 9 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|---|---|--|---|
| 18. | Shqyrtim dhe miratim i ndryshimeve dhe plotësimeve vetëm më të miratuara të Ligjit për procedurë penale (LPP) | <ul style="list-style-type: none"> Rimbledhja e grupit të punës për ndryshime në LPP, të formuar në Ministrinë e drejtësisë ose formimin e grupit të ri të punës. | MD | <p>6 (shqyrtim dhe përcaktim i më-tutjeshme i ndryshimeve dhe plotësimeve të nevojshme; 9 (miratim)</p> |
| 19. | Formim i qendrave hetuese të Prokurorisë publike, në përputhje me nenin 45 të LPP | <ul style="list-style-type: none"> Ndërmarrja e veprimeve dhe aktiviteteve përgatitore nga ana e Prokurorit publik të rizgjedhur, përfshirë marrje të vendimit për formimin e tyre. | PPRM | 12 |
| 20. | Ndryshime ligjore për zgjedhje të drejtorit dhe anëtarëve të ri të Këshillit drejtues të Akademisë për gjykatës dhe prokuror publik (AGjPP) | <ul style="list-style-type: none"> Propozim-ndryshime të Akademisë për gjykatës dhe prokuror publik. | MD | 6 |
| 21. | Ndryshim dhe avancim të kriterëve të AGjPP për praninë të ndjekësve të trajnimit fillestar, si dhe për zgjedhje të trajnuesve | <ul style="list-style-type: none"> Propozim-ndryshime të Akademisë për gjykatës dhe prokuror publik. | MD (proces përfshirës me pjesëmarrje të organizatave qytetare) | 6 |
| 22. | Themelimi i praktikës së marrjes së vendimeve me kompetencë të plotë nga ana e Gjykatës administrative dhe mbajtja e seancave publike në rastet kur ajo është e domosdoshme | <ul style="list-style-type: none"> Ndërmarrja e hapave për ndryshime të praktikës administrativo-gjyqësore në përputhje me nevojat për mbrojtje efikase gjyqësore të të drejtave dhe lirive njerëzore. | Gjykata administrative | 9 |

LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

Rëndësi të veçantë ka themelimi dhe riafirmimi i institucioneve për luftën kundër korrupsionit, në mënyrë që do të rrit efektivitetin e tyre dhe do të përforcon kontrollin e jashtëm dhe mekanizmat për përgjegjësi për shkak të kryerjes joprofesionale dhe të pavetëdijshme të autorizimeve të tyre, veçanërisht në rastet kur edhe vet ato do të bëhet të korruptuar. Andaj, duhet përkushtuar vëmendje dy prioriteteve. I pari është rritja e integritetit të institucioneve, nëpërmjet përforsimit të tyre, pajisjes me persona me integritet që marrin iniciativa dhe janë llogaridhënës. Prioriteti i dytë është zvogëlimi i klientelizmit nëpërmjet sigurimit të mekanizmave për llogaridhënie dhe mbikëqyrje të jashtme, të dhëna, praktika dhe procedura që zvogëlojnë rreziqet nga korrupsioni në fushat kyçe.

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|---|--|---|--------------|
| 1. | Rritja e integritetit të institucioneve | <ul style="list-style-type: none"> Kuvendi sjell rezolutë me të cilën kërkohet dorëheqja e anëtarëve të KShPK. | Kuvendi | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Kuvendi kërkon nga Prokurori publike për krim të organizuar dhe korrupsion raport të posaçëm për punën e saj, me informata të sakta statistikore për rastet që i drejton ku veprat janë pjesërisht ose tërësisht të klasifikuara si korrupsion. Në raportin duhet të kërkohet shqyrtim për të dhënat e desegreguara në luftën kundër korrupsionit të lartë, mesëm dhe të ulët. | Kuvendi | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> KSHPK shpall të dhëna historike (në format të hapur) dhe ndryshime në listat anketuese të personave të zgjedhur dhe emëruar dhe e zgjeron vëllimin e informatave që i posedon. | Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (K-SHPK) | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> KSHPK dhe MD të përgatisin raport të posaçëm për zbatim të Ligjit për mbrojtje të informatorëve. | KSHPK, MD | 3 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|-----------|--|---|--------------|
| | | <ul style="list-style-type: none"> Zbatimi i vlerësimeve të rreziqeve nga korrupsioni dhe zhvillimit të planeve për integritet në ministritë kyçe. Ato institucione janë: Ministria për punë të brendshme (MPB), Drejtoria për siguri dhe kundërzbulim (DSK), të gjitha inspektoratet, të gjitha institucionet që japin ndihmë dhe subvencione, si dhe ato që mbledhin të ardhura. Në bazë të rekomandimeve nga planet për integritet, afatmesëm, këto institucione duhet të plotësojnë zbrazëtirat në rregulloret dhe të zhvillojnë mekanizma shtesë për kontroll, aty ku janë identifikuar rreziqe. | MPB, DSK, Drejtoria për të ardhura publike (DAP), Prokuroria publike për ndjekje të kimit të organizuar dhe korrupsionit, Prokuroria publike e RM (PPRM), Policia financiare, MBPEU, Ministria për punë dhe politika sociale (MPPS) | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Rishikim i të gjitha informatave të klasifikuara në institucionet shtetërore, ndjekur me shpalljen e lëndëve që nuk janë të lidhur me sigurinë e shtetit por janë "të klasifikuara si të tilla". | Qeveria + institucionet | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Përmirësim i kriterëve për anëtarët e KSHPK (Ndryshim i Ligjit për parandalim të korrupsionit), përfshirë edhe fokusin dhe ekspertizën në vend të arsimit, si dhe mbajtjen e debatit publik në Kuvend ku organizatat qytetare me përvojë të dëshmuar do të mund të dëgjojnë kandidatët, si pjesë e procesit të përzgjedhjes. | Ministria e drejtësisë (MD); Kuvendi | 6 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Ndryshim i Ligjit për furnizime publike me qëllim që secili furnizim i ardhshëm të duhet të ketë linjë buxhetore paraprakisht të përcaktuar. | Qeveria; Kuvendi | 6 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Ministria për financa siguron qasje në shpenzimet ditore të përdoruesve buxhetor sipas transaksioneve, në formë të të dhënave të hapura nga të gjitha llogaritë që institucionet kanë në dispozicion. Grupi i punës në afat prej 3 muaj të përcakton se cilat të dhëna do të publikohen, në çfarë formati, sa shpesh (javor, mujor...). | MF | 6 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|-----------|--|---|--------------|
| | | <ul style="list-style-type: none"> Ndryshim i nenit 23 nga Ligji për revizion shtetëror, me qëllim që të parashikohet revizioni i detyrueshëm vjetor i partive politike. | EShR; Kuvendi | 6 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Emërtimi i anëtarëve të ri të Komisionit për mbrojtje të së drejtës për qasje ndaj informatave me karakter publik (KMDQIKP). Ato duhet të jenë ekspertë të pavarur me përvojë të pasur në fushën e qasjes ndaj informatave. | MD; Kuvendi | 6 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> T'i mundësohet KMDQIKP të mund të nis procedura ndëshkimore kundër mbajtësve të informatave që nuk veprojnë sipas kërkesave. | Kuvendi; Komisioni për mbrojtje të së drejtës për qasje ndaj informatave me karakter publik (KMDQIKP) | 6 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Të vendosen kompetenca për publikimin dhe deklasifikimin e informatave të kategorizuara si të "brendshme" për qëllime të ruajtjes së interesit publik, ashtu siç është përcaktuar me Ligjin për mbrojtje të informatorëve. | Qeveria | 6 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Obligim dhe sigurim i resurseve që institucionet në mënyrë aktive të shpallin dokumentet dhe vendimet që janë kategorizuar si informata publike. | Qeveria; KMD-QIKP | 6 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Të sigurohen mjaft resurse (njerëzore – ekspertë për të dhëna) që të mundësohet shqyrtimi i thellë i konfliktit të interesave dhe korrupsionit të të gjithë personave të emëruar dhe të zgjedhur si dhe për administratën, me kontrole të kryqëzuara automatike me të dhënat nga furnizimet publike dhe punësimet. | Ministria e financave (MF); Kuvendi; KSHPK | 6 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Vendosja e një sistemi të posaçëm i cili automatikisht do të hap lëndë për shqyrtim për KSHPK në raste kur listat anketuese nuk janë të plota, gjegjësisht kur mungojnë informata për burimin e pronës. | MD; KSHPK | 6 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Përsëri të vendoset dhe të bëhet më efikas detyrimi ligjor për lidhje të ndërsjellë mes DAP dhe KSHPK për kontroll të kryqëzuar të listave anketuese. | KSHPK; DAP | 9 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|-----------|--------------------------|---|--|---|
| | | <ul style="list-style-type: none"> Të themelohet dhe të rritet kapaciteti i qendrave hetuese të PPKOK. | MF; Kuvendi | 9 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Hapje e debatit publik për ndryshim të modelit të KSHPK nëpërmjet ndryshimit të Ligjit për parandalim të korrupsionit. Formim i grupi të punës të përbërë nga organizata qytetare, shërbime profesionale të KSHPK, MD dhe institucione tjera që do të përgatisin propozim-ndryshime të Ligjit. Kjo do të përfshin kritere të reja për emërim, mënyrë të re për zgjedhje, por edhe përcaktim më të mirë të kriterëve për përgjegjësi. | shërbimet profesionale të KSHPK, MD; organizatat qytetare | 12 |
| 2. | Zvogëlim i klientelizmit | <ul style="list-style-type: none"> BFP të shpall të gjitha të dhënat për furnizime publike si të dhëna të hapura, që t’ju mundësohet organizatave qytetare të hulumtojnë ekzistimin e rrjeteve klientilistike. Të rishqyrtohet përdorimi i çmimit më të ulët si kriter të vetëm. Sipas direktivës së re të BE “oferta më e volitshme ekonomike” është përcaktuar si kriter kryesor, i përbërë prej më shumë elementeve, ku përskaj çmimit theksohen edhe cilësia dhe efektiviteti i çmimit. Ndalesë për blanko-dorëheqje të personave të zgjedhur dhe të emëruar. Ndalesë për vlefshmërinë e kambialeve të personave të zgjedhur dhe të emëruar që i bëjnë të varur nga partitë politike ose patronët e tyre politik. Ndëshkimi i praktikës së tillë duhet të përfshihet në Kodin zgjedhor. Këto sanksione duhet të përfshijnë edhe ndalesë për pjesëmarrje në zgjedhjet e ardhshme. Përgatitja e analizës së mjeteve financiare dhe implikimeve dhe mjeteve buxhetore të nevojshme për zbatim të përshtatshëm të Ligjit për mbrojtje të informatorëve. | <p>Byroja për furnizime publike (BFP)</p> <p>MF; BJH</p> <p>Kuvendi; JOPM</p> <p>KSHPK; MF</p> | <p>3</p> <p>3</p> <p>3</p> <p>3</p> |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|-----------|--|---|--------------|
| | | <ul style="list-style-type: none"> Byroja për furnizime publike siguron qasje organizatave qytetare në vet vendin që të vëzhgojnë punën e komisioneve për furnizime publike. Veç kësaj, duhet të sigurohet që institucionet të shpallin dokumentimin e plotë të ofruesve, që t’ju ndihmohet me mbikëqyrje qytetare. | MF; BFP | 6 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Regjistri tregtar të sigurohet falas (alternativë e organizatave qytetare dhe gazetarëve). | Qeveria; Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë | 6 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Të krijohet grup pune mes KSHPK, DAP, Policisë financiare dhe ESHR që të hulumtohet financimi i partive politike dhe shpenzimi në tre vitet e kaluara. Metodologjia, gjetjet dhe rekomandimet për hapat e ardhshëm duhet të konsultohen me organizatat qytetare (me përvojë të dëshmuar në fushën e financimit të partive politike) në më shumë faza të përpilimit të analizës dhe hetimit, që të sigurohet transparencë dhe llogaridhënie se proceset që do të dalin nga gjetjet me të vërtet do të zbatohen. | KSHPK; ESHR, DAP, PF | 6 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Të ndryshohet Ligji për mbrojtje të informatorëve që mos t’ju mundësohet gjykatave të shpalojnë identitetin në çfarëdo çasti pa pëlqim paraprak. Zbatim i rekomandimeve nga Komisioni i Venedikut. | MD; Kuvendi | 6 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Institucionet të propozojnë persona që do të pranojnë paraqitjet prej informatorëve, kurse informatën ta përcjellin deri tek KSHPK. KSHPK rregullisht të azhurnon listën e personave të propozuar. | OASH; KSHPK | 6 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Rritje e specifikimeve teknike që sigurojnë anonimitet të informatorëve në çdo kohë. | MD ; KSHPK; Kuvendi | 6 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Tërheqja e anëtarëve nga Ligji që themelojnë Këshillin për furnizime publike dhe shpërbërjen e anëtarëve të Këshillit. | Kuvendi | 6 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|-----------|---|-----------------------------|--------------|
| | | <ul style="list-style-type: none"> Rishikim dhe ndryshim i të a.q. referenca negative për kompanitë. | MF; BFP | 6 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Vendosja e ad-hoc komisioneve të posaçme në Kuvend për ndjekje të furnizimeve të mëdha publike. | Kuvendi | 6 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Përforsim i zbatimit të kornizës ligjore të masave ligjore për tatum 70 përqindësh të pronës ilegale dhe të nisët zbatim i përshtatshëm i Kodit penal në pjesën për fshehjen e prejardhjes së pronës së fituar në mënyrë të papërshtatshme (neni 359-a). | DAP | 6 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Shpallja e informatave për pronësi në emër të partive politike. | EShR | 6 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Lidhja e Regjistrimit të pronës, të ardhurat dhe interesat e personave të zgjedhur dhe të emëruar me DAP. | KSHPK; DAP | 6 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Ndryshim i Kodit zgjedhor ku një parti politike që dy vite me rend do ketë raport revizor me kualifikim nuk mund të merr pjesë në zgjedhje. Grupi i punës nga EShR dhe MD në afat prej 3 muaj të përcakton se çfarë lloji i kualifikimit do të konsiderohet si negativ. | MD; Kuvendi | 9 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Përforsim i kompetencave të EShR, së bashku me Policinë financiare dhe BKRM për mbikëqyrje të të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe prejardhjes së parave të dhuruara partive politike. | EShR; PF; BKRM | 9 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Të përforsohet zbatimi i konfiskimit përfundimtar në fazën e hershme të procedurës penale për raste të lidhura me korrupsion. | PPRM; KSHPK; EShR | 9 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Themelim i sistemit për financim të partive politike vetëm prej mjeteve publike dhe ndalesë për çfarëdo lloji donacioni privat. Të gjitha partitë e regjistruara politike do të fitojnë shumën themelore të parave, kurse mjete shtesë do të sigurohen proporcionalisht me numrin e d]vendeve të deputetëve (ose përfaqësuesve) në këshillat komunal. | MD | 12 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|-----------|---|-----------------------------|--------------|
| | | <ul style="list-style-type: none"> Mendim i ndryshëm për financimin e partive politike: Themelimi i mekanizmit për kontroll të detyrueshme të prejardhjes së mjeteve për secilin donacion dhe rritje të tatimit për donacione dedikuar partive politike. Qëllimi i kësaj është të rriten të ardhurat publike për intervenime në fusha tjera me interes publik. | MD | 12 |

ZGJEDHJE DHE SISTEMI ZGJEDHOR

Prioritetet kyçe në këtë fushë janë: vazhdimi me reformat e Komisionit shtetëror zgjedhor (KShZ) dhe administratën zgjedhore dhe pastrimin e Listës zgjedhore. Përveç kësaj, propozohet tejkalmimi i disa vështirësive afatgjate të zgjedhjeve dhe të sistemit zgjedhor lidhur me mënyrën e zgjedhjes së deputetëve, votimi jashtë vendi, rregullimi i fushatës zgjedhore dhe pjesëmarrja e personave me nevoja të posaçme në procesin zgjedhor.

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|--|--|---|--------------|
| 1. | Vazhdim me reformën e KSHZ dhe administratës zgjedhore | <ul style="list-style-type: none"> Ndryshim i Kodit zgjedhor (KZ) – Zgjedhje e sekretarit të përgjithshëm të KShZ me 2/3 e votave. | Ministria e drejtësisë (MD), Kuvendi i RM | 6 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Ndryshime të KZ: ndryshim i përbërjes së komisioneve zgjedhore komunale dhe të këshillave zgjedhor – 1 anëtar nga administrata dhe 4 anëtarë nga partitë politike. | MD, Kuvendi i RM | 6 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Formim i organit të posaçëm në kuadër të KShZ i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrje drejtpërdrejte të organeve më të ultë zgjedhore. | KShZ | 6 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> rishikimi dhe optimizimi i buxhetit të KShZ nëpërmjet shkurtimeve të shpenzimeve të panevojshme dhe financim përkatës për nevojat e vërteta. | KShZ, Ministria për financa (MF) | 6 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Vlerësim i resurseve njerëzore dhe kompetencave të të punësuarve në shërbimin profesional të KShZ dhe veprimi përkatës (largim nga puna ose punësim i kuadrove të reja). | KShZ, sekretari i përgjithshëm | 9 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Dixhitalizim i punës së KShZ dhe administratës zgjedhore. | KShZ | 12 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|--|--|--|--------------|
| 2. | Pastrim i listës zgjedhore | <ul style="list-style-type: none"> Ndarje e zgjedhësve me regjistra të dyshimtë në listë të posaçme zgjedhore për zgjedhjet lokale. | MD, KShZ | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Përgatitje e protokollit të ri për komunikim efikas dhe efektiv mes institucioneve kompetente për përditësim të Listës zgjedhore, përfshirë edhe nëpërmjet takimeve të grupit të punës për pastrim të Listës zgjedhore. | KShZ, Ministria për punë të brendshme (MPB), gjykatat dhe Drejtoria për administrim me libra amë | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Përgatitja e metodologjisë së re për administrim dhe përditësim të Listës zgjedhore që do të zëvendëson dy metodologjitë ekzistuese dhe do të përfshinë dispozita dhe procedura të qarta për të gjitha aspektet e këtij procesi. | KShZ | 6 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Krijimi i një baze qendrore të të dhënave / regjistër civil që do të udhëhiqet nga një organ i pavarur dhe në të cilin do të mblidhen të dhëna për qytetarët që i posedojnë të gjitha institucionet shtetërore. | Qeveria e RM, Kuvendi e RM | 12 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Zgjedhja e problemit me emrat e rrugëve dhe numrat e shtëpive, dhe rregullimi i kushteve për ndryshim të emrave të rrugëve. | Agjencia për kadastër, Regjistri qendror, njësitë për vetëqeverisje lokale, Kuvendi i RM | 12 |
| 3. | Tejkalimi i dobësive të procesit zgjedhor dhe të sistemit zgjedhor | <ul style="list-style-type: none"> Rishikim i KZ me qëllim që të largohen të gjitha zbrazëtitat ligjore dhe kundërshtimet, si dhe të unifikohen termet e ndryshme ose joprecize për aspekte të caktuara të procesit zgjedhor. | MD, Kuvendi i RM | 12 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Sinkronizimi i Kodit zgjedhor me ligjet tjera që janë të lidhura me aspekte të ndryshme të procesit zgjedhor. | MD dhe institucionet tjera kompetente, Kuvendi i RM | 12 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|-----------|--|---|--------------|
| | | <ul style="list-style-type: none"> Hapja e debatit të gjerë për mundësitë për përmirësim të sistemit zgjedhor, nëpërmjet futjes së votimin preferencial, si dhe debate mbi numrin e njësive zgjedhore, dhe nëse është e nevojshme ndryshim të KZ. | MD, Kuvendi i RM, KShZ, partitë politike, ekspertët, shoqëria qytetare | 12 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Hapja e debatit të gjerë për të gjitha aspektet e votimit jashtë nga shteti: numri dhe vendbanimi i qytetarëve të RM që jetojnë jashtë vendit, sistemi zgjedhor, numri i njësive zgjedhore, numri i deputetëve, barazia e votës, mënyra e votimit, etj. gjithçka që duhet të vijon dhe ndryshim të KZ. | MD, Kuvendi i RM, KShZ, partitë politike, ekspertët, shoqëria qytetare, përfaqësuesit e diasporës | 12 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Rregullimi i aktiviteteve të lejuara të partive politike në periudhën para shpalljes së zgjedhjeve dhe vërtetimit të listave të kandidatëve. Opsionet alternative janë që fushata të zgjat nga vet shpallja e zgjedhjeve ose aspak mos të jetë e rregulluar. | MD, Kuvendi i RM | 12 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Mundësimi i kushteve të barabarta për pjesëmarrje të personave me aftësi të kufizuara në procesin zgjedhor (status i personave me aftësi të kufizuara, qasje deri tek vendvotimi, mënyra e rregullimit të vendvotimit dhe kutisë së votimit, kabinat e votimit, udhëzimet për votim, mënyra e votimit, fletat e votimit dhe materialet tjera, ueb-faqja e KShZ). Ndryshim i KZ (aty ku është e nevojshme). | MD, Kuvendi i RM, KShZ | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Përputhje e legjislaturës zgjedhore me dispozitat e Konventave të KB për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, me përfshirje të personave me pengesa dhe qytetarëve që i përfaqësojnë në këtë proces. | Qeveria e PM, MD, Kuvendi i RM, KShZ | 12 |

ADMINISTRATA PUBLIKE

Aministrata publike është shumë e politizuar dhe e përdorur si një prej shtyllave kryesore të klientelizmit partiak. Ndryshimet e shpeshta të kornizës ligjore, zbatimit të saj selektiv dhe mungesës së transparencës kanë krijuar pasiguri brenda në administratë, por edhe në lidhje me sigurimin e shërbimeve për qytetarët. Procesi dhjetëvjeçar i punësimit dhe avancimit joobjektiv ka kontribuar në kontrollimin e institucioneve.

Masat e propozuara janë në drejtim të përfundimit të sistemit për punësim dhe avancim sipas vlerave dhe meritave, që do të nxit profesionalizmin dhe kompetencat në administratën publike. Qëllimi përfundimtar është të kthehet integriteti i institucioneve dhe besimi në ato, si dhe të zhvillohet një administratë e cila është proporcionalisht e dimensionuar, profesionale, politikisht e pavarur dhe efikase. Duke marr parasysh praktikën shumë të pranishme të përzjerjes së shtetit dhe partisë, Qeveria e re do duhet të siguron ndarje efektive të shtetit prej partisë.

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucion/i kompetent/et | Afat (muaj) |
|----------|--------------------------------|---|--|-------------|
| 1. | Transparençë dhe llogaridhënie | <ul style="list-style-type: none"> Rritja e vëllimit të të dhënave të hapura të shpallura nga Qeveria dhe nga institucionet e sektorit publik, përfshirë nëpërmjet transparencës aktive (QRM të merr vendim, me të cilin secili institucion nga sektori publik do të jetë përgjegjës që në ueb-faqe të publikon raportin vjetor për punë në tre vitet e fundit, strategjitë dhe planet e veprimit për të cilat është kompetente ti zbaton, planin vjetor për punë, sistematizimin e vendeve të punës me organgram, si dhe përgjigjet e kërkesave për qasje publike ndaj informatave të dhëna në tre vitet e fundit). | QRM, gjitha institucionet e sektorit publik | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Shpallje e rregullt dhe e kohëshme e rendit ditor dhe procesverbalet nga seancat e mbajtura të QRM, si dhe të vendimeve të mara, përfshirë ato që nuk shpallen në Gazetën zyrtare të RM. | QRM, Sekretariati i përgjithshëm | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Përgatitja e rekomandimeve për menaxhim me të dhëna të hapura, si dhe vendosje të standardeve minimale për administratën lokale dhe qendrore. | Ministria për shoqëri informatike dhe administratë (MShIA) | 9 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucion/i kompetent/et | Afat (muaj) |
|-----------|--------------------------------|---|--|-------------|
| | | <ul style="list-style-type: none"> Shqyrtim/revizion të të gjitha informatave të klasifikuara në kuadër të administratës shtetërore (informata që nuk kanë të bëjnë me sigurinë e shtetit, por janë “të klasifikuara si të tilla” nga ana e poseduesve të informatave me qëllim që të mbulohen shpenzimet e buxhetit shtetëror). | Drejtoria për informata të klasifikuara, QRM, organet e administratës shtetërore (OASH) | 9 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Zgjerim i mandatit të Komisionit për mbrojtje të të drejtës për qasje të lirë ndaj informatave me karakter publik për nisje të procedurës kundërvajtëse kundër poseduesve të informatave që nuk i kanë dorëzuar informatat e nevojshme në kohë. | MD, Komisioni për mbrojtje të së drejtës për qasje të lirë ndaj informatave me karakter publik | 12 |
| 2. | Menaxhimi me resurse njerëzore | <ul style="list-style-type: none"> Miratimi i udhëzimit për parandalim të keqpërdorimit të resurseve shtetërore për qëllime partiake me instruksione në detaje për zbatim të dispozitave të caktuara ligjore prek ligjeve dhe akteve nënligjore përkatëse. | QRM | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Përgatitja e raportit me të dhëna gjithëpërfshirëse për punësim në bazë të kontratave në vepër, punësimi nëpërmjet agjencive për punësim të përkohshëm, kontrata konsulente etj. (si vlerë minimale, informata duhet të përmban të dhëna mbi llojin e kontratës, kohëzgjatjen, shumën/rrogën, karakteristikat demografike, etj.). | MShIA | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Rritja e transparencës së të dhënave mbi të punësuarit në sektorin publik: <ol style="list-style-type: none"> Publikimi i listave të personave të punësuar (vendeve të punës të plotësuar) në sektorin publik (emër dhe mbiemër, kategori/profesion dhe vend pune, viti i punësimit në sektorin publik dhe gjithsej përvoja e punës, përshkrim i vendit të punës dhe detyrat, dhe kontakt-detaje); Shpallja e pasqyrës së masave disiplinore të dhëna dhe rezultateve nga vlerësimi i të punësuarve (sipas kategorive të lartpërmendura, që të mundësohet vlerësim i praktikave të punësimit). | MShIA, gjitha institucionet nga sektori publik | 3 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucion/i kompetent/et | Afat (muaj) |
|-----------|---------------------------|--|----------------------------|-------------|
| | | <ul style="list-style-type: none"> • Sigurimi i gjithpërfshirjes në metodologjinë që zbatohet gjatë përpilimit të raportit nga regjistri i të punësuarve në sektorin publik (përfshirje e të gjitha institucioneve në sektorin publik, me të dhëna të desegreguara sipas llojit të punësimeve (përfshirë edhe punësime të përkohshme), kurse të dhënat të mirëmbahen dhe përditësohen në nivel të institucionit dhe në nivel të sektorit publik). | MSHIA | 9 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> • Kthimi i formatit të komisioneve disiplinore me tre anëtarë dhe rritje të përgjegjësisë të departamenteve për menaxhim me resurse njerëzore në procedura disiplinore. | MSHIA | 9 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> • Shqyrtim/revizion të metodologjisë për vlerësim të nëpunësve administrativ dhe prezantimi i metodologjisë së përputhur për vlerësim të të gjithë të punësuarve në sektorin publik. | MSHIA | 6 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> • Zbatim konsistent dhe të rregullt të nenit 19a të LNA (Komisioni për revizion të procedurës për përzgjedhje të nëpunësve administrativ tek Agjencia për administratë), përfshirë edhe revizionin e të gjitha procedurave për selekcionim të zhvilluara në vitet 2015 dhe 2016. Gjithashtu, të shqyrtohet mundësia e zgjerimit të mandatit të Komisionit. | MSHIA, AA | 9 |
| 3. | Avancimi zbatimit të LPPA | <ul style="list-style-type: none"> • Përgatitja e informatës për zbatimin e deritanishëm në LPPA, me identifikim të sfidave kyçe dhe propozim zgjedhjeve. | MSHIA | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> • Zbatim konsistent i LPPA nëpërmjet formimit të njësive organizative për udhëheqje të procedurave administrative dhe avancim i nëpunësve udhëheqës që të zgjedhin në procedurat administrative (zgjidhja të varet prej sistematizimit, gjegjësisht prej vendit të punës). | OASH | 6 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucion/i kompetent/et | Afat (muaj) |
|----------|---|--|----------------------------|-------------|
| 4. | Strategji përfshirëse dhe cilësore për reforma të administratës publike (RAP) | <ul style="list-style-type: none"> Përpilim i analizës së plotë funksionale për të gjitha institucionet e pushtetit ekzekutiv [edhe prej sektorit publik]. | QRM, MSHIA | 12 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Të shqyrtohet mundësia për riformim të ose largim nga vendet e hapura të punës, kështu që kjo praktikë do ishte përjashtim dhe jo parim i përgjithshëm për punësim të nëpunësve shtetëror. <u>ALTERNATIVA:</u> themelimi i sistemit më të rreptë të karrierës (mendimet mbi këtë çështje dallojnë). | MSHIA | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Themelimi i një grupi të nëpunësve të lartë shtetëror, e cila do të jetë tërësisht profesionale, kurse mandati i tyre do të ndahet nga mandati i Qeverisë. | MSHIA | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Themelimi i shërbimit shtetëror gjithëpërfshirës, në të cilin do të përfshihen gjitha institucionet e pushtetit qendror ekzekutiv, për të cilët do të vlejnjë rregullat e njëjta për menaxhim me resurse njerëzore. Harmonizim i rregulloreve të posaçme me kornizën e përgjithshme ligjore (LNA dhe LPSP). | MSHIA | 12 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Përfundimi dhe zgjerimi i rolit të Agjencisë për administratë, veçanërisht për trajnimin (Akademia për trajnim) dhe testimin dhe vlerësimin e suksesit të politikave (Qendra për shkëlqyeshmëri). | MSHIA | 6 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Rishqyrtimi i modelit të trajnimit – analizë funksionale, në përputhje me nevojat dhe kompetencat e nëpunësve administrativ. | MSHIA | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Rregullim gjithëpërfshirës i çështjeve për kabinetet e udhëheqësve politik (përfshirë edhe rolet, të drejtat dhe përgjegjësitë e këshilltarëve të posaçëm dhe nëpunësve të kabineteve vis-a-vis nëpunësve profesional administrativ, numrit të këshilltarëve, rrogave të tyre, shpërblimeve, etj.). | MSHIA | 6 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Përfshirja e masave për sigurim të interoperabilitetit të bazave të ndryshme të të dhënave. | MSHIA | 3 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucion/i kompetent/et | Afat (muaj) |
|----------|---|---|----------------------------|-------------|
| 5. | Krijimi i politikave përfshirëse në bazë të provave | <ul style="list-style-type: none"> Të gjitha ministratë të shpallin planet vjetore për vlerësim të ndikimit të rregullativës. . | QRM, OASH | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Zbatim konsistent, i kohshëm dhe tërësishtëm i Metodologjisë për vlerësim të ndikimit të rregullativës, përfshirë edhe konsultimet e detyrueshme me shoqërinë qytetare. | OASH | 9 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Përgatitja e raportit për vetëvlerësim të procesit konsultativ në vitin e kaluar (informata kthyesë nga të gjitha palët e prekura, përgjigje nga institucionet, propozime të pranuar/refuzuara, shkaqet, etj.). | OASH | 9 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Rritja e qasshmërisë dhe cilësisë së të gjitha dhënave që administrata i prodhon si evidencë e punës së saj. | OASH | 9 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Publikim i planeve për vlerësim dhe zbatim të dy ex-post analizave të ligjeve për vitin e kaluar. | OASH | 12 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Vazhdim i kornizës kohore për konsultime me RVER së paku 20 ditë. | MSHIA, QRM | 6 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucion/i kompetent/et | Afat (muaj) |
|----------|---|---|---|-------------|
| 6. | Zbatim i parimit të përfaqësimit përkatës dhe të drejtë | <ul style="list-style-type: none"> Plotësimi i vendeve të zbrazura të kuadrove udhëheqëse në institucione, në përputhje me meritat dhe përfaqësimin e drejtë. | MSHIA | 6 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Zbatimi i metodologjisë së punësimit në sektorin publik, përfshirë edhe nëpërmjet shpërndarjes së nëpunësve vetëm më të punësuar në bazë të parimit të përfaqësimit të drejtë dhe zbatimit të sanksioneve nëse nuk zbatohet metodologjia. | MSHIA | 12 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Themelimi i modelit për menaxhim me dallueshmëritë në kuadër të administratës publike. | MSHIA, Sekretariati për zbatim të Marrëveshjes kornizë të Ohrit | 12 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Zbatimi i parimit të përfaqësimit përkatës dhe të drejtë, a.q. parimi i meritave, gjatë punësimit në sektorin publik, me theks të posaçëm mbi bashkësive më të vogla të cilat nuk janë të përmendura në Kushtetutë. | MSHIA | 12 |

KONTROLLI MBI POLICINË DHE AGJENCITË PËR SIGURI DHE (KUNDËR)ZBULIM

Ndonëse puna e Ministrisë për Punë të Brendshme dhe shërbimeve për kundërzbulim dhe zbulim janë lëndë e kontrolleve të mekanizmave të brendshëm dhe të jashtëm, ato nuk kanë arritur rezultatet e pritura, dhe dëshmi më e madhe për atë janë bisedat e paligjshme të përgjuara që ishin publikuar gjatë vitit 2015.

Në vitin 2012, partitë opozitare në atë kohë në Kuvend kanë dorëzuar propozim-ligj për avokatin policor, por kjo ishte refuzuar nga shumica parlamentare. Në prill të vitit 2014, MPB deklaroi që do të themelojë një mekanizëm të pavarur për kontroll të jashtëm. Në vitin 2016, me mbështetjen e Këshillit të Evropës dhe MPB, ishte formuar grupi i punës me ekspertë prej të cilës kanë dalë propozime konkrete për zgjidhje të gjendjes në Maqedoni.

Qëllimi kryesor është të sigurojë kontroll të besueshëm, efektiv dhe të jashtëm civil mbi policinë dhe shërbimet sekrete ndërsa mekanizmi i ardhshëm i pavarur për kontroll të jashtëm mbi policinë të përfshijë edhe anëtarë (në baza të barabarta) të organizatave qytetare, universitete, prokurori publike dhe nëpunës të pensionuar policor me përgjegjësi dhe detyra të njëjta, të përforcohet kontrolli parlamentar mbi policinë dhe shërbimet për zbulim, të rritet kontrolli financiar mbi Ministrinë e Punëve të Brendshme, si dhe të përforcohet mbikëqyrja mbi punën e shërbimeve për siguri dhe (kundër)zbulim nga ana e mekanizmave të pavarur kontrollues.

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|---|---|--|--------------|
| 1. | Vendosja e një mekanizmi të jashtëm për kontroll mbi policinë | <ul style="list-style-type: none"> Të hapet debat publik në lidhje me propozimet e grupit të punës së ekspertëve, mbështetur nga Këshilli i Evropës, për mekanizëm të jashtëm të mbikëqyrjes së punës së policisë me anë të trupit të pavarur për kontroll qytetar ose me anë të departamentit të veçantë në kuadër të Avokatit të Popullit. | Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Ministria e Drejtësisë (MD), Prokuroria Publike (PP), Këshilli i Prokurorëve Publik, Kuvendi, Avokati i Popullit (AP) | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Të mbështetet zgjidhjet ligjore të propozuar nga grupi i punës, e mbështetur nga Këshilli i Evropës, për mbikëqyrje të punës së policisë nga ana e Prokurorisë Publike. Institucionet shtetërore të kërkojnë kycje të Këshillit të Evropës për shkak të vazhdimit dhe përfundimit të procesit. | MPB, MD, PP, Kuvendi | 9 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Të formohet grup pune për përgatitjen e propozim-ligjit për mekanizëm të jashtëm për mbikëqyrje të punës së policisë. | MPB, MD, PP, Kuvendi, AP | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Të hapet debat publik në lidhje me kornizën e propozuar ligjore për mekanizëm të jashtëm të mbikëqyrjes së punës së policisë. | MPB, MD, PP, Kuvendi, AP | 6 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Të miratohen ndryshime ligjore që do të mundësojnë mekanizëm të jashtëm për mbikëqyrje të punës së policisë. | MPB, MD, PP, Kuvendi, AP | 9 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|--|---|---|--------------|
| 2. | Përmirësim të mekanizmit të kontrollit mbi policinë | <ul style="list-style-type: none"> Të formohet grup pune për revizion dhe ndryshim të zgjidhjeve ligjore dhe nënligjore me Departamentin për Kontroll të Brendshëm, Hetime Kriminele dhe Standarde Profesionale. | MPB, MD, PP, Kuvendi, AP, përfshirje të Sindikatës Policore | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Të hapet debat publik për revizion dhe ndryshim të zgjidhjeve ligjore dhe nënligjore me Departamentin për Kontroll të Brendshëm, Hetime Kriminele dhe Standarde Profesionale. | MPB, MD, PP, Kuvendi, AP, përfshirje të Sindikatës Policore | 6 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Të miratohen zgjidhje ligjore dhe nënligjore me Departamentin për Kontroll të Brendshëm, Hetime Kriminele dhe Standarde Profesionale. | MPB, MA, PP, Kuvendi, AP, përfshirje të Sindikatës Policore | 9 |
| 3. | Rritja e kontrollit financiar të Ministrisë së Punëve të Brendshme | <ul style="list-style-type: none"> Të bëhet revizion i jashtëm i punës financiare të Ministrisë së Punëve të Brendshme. | MPB, Enti Shtetëror për Revizion (EShR) | 6 |
| 4. | Përmirësim i integritetit të policisë | <ul style="list-style-type: none"> Formim i grupit të punës me anë të një procesi përfshirës për zhvillim të planit për integritet të policisë. | MPB | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Krijimi i një plani të ri për integritet të policisë. | MPB | 9 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|---|--|--|--------------|
| 5. | Përmirësimi i funksionimit të sistemit të sigurisë/zbulimit në funksion të efikasitetit më të madh, punë ligjore dhe respektim i të drejtave të njeriut | <ul style="list-style-type: none"> Ndryshim i Ligjit për Komunikime Elektronike me qëllim të merret roli ndërmjetësues i DSK dhe qasja e drejtpërdrejtë në pajisjen teknike që lejon pasqyrimin e sinjalit të komunikimit, gjegjësisht qasjen për të siguruar vetëm me urdhër gjyqësor. | Ministria e Shoqërisë Kompjuterike dhe Administratë (MSKA), MPB, Drejtoria për Siguri dhe Kundërzbulim (DSK), Kuvendi, Agjencia për Komunikime Elektronike (AKE) | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Të formohet grup pune mes resorëve për vlerësimin e funksionimit të sistemit të sigurisë-zbulimit/kundërzbulimit. | MPB, kryetari i RM, Ministria e Mbrojtjes (MB), MD, Agjencia për Kundërzbulim (AK), Kuvendi, DSK | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Të përgatitin propozim-zgjidhje për ndryshim të kornizës ligjore, në drejtim të funksionimit të sistemit të sigurisë-zbulimit/kundërzbulimit. | AK, Kuvendi, DSK | 12 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|--|---|---|--------------|
| 6. | Përforcimi i kontrollit parlamentar mbi punën e agjencive për siguri dhe (kundër) zbulim | <ul style="list-style-type: none"> Përforcim të kapaciteteve të Komisionit për Mbikëqyrje të punës së zbatimit të masës së veçantë hetimore “ndjekje të komunikimeve” dhe Komisionit për Mbikëqyrje mbi punën e Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim (DSK) dhe Agjencisë për Zbulim (AZ), me anë të angazhimit të personave profesional. | Kuvendi | 9 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Të vendoset bashkëpunim të komisioneve të Kuvendit me trupat tjerë që kanë rol në mbikëqyrjen dhe kontrollin e shërbimeve të sigurisë-zbulimit. | Kuvendi, Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, EShE, PP, AP | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Të ndryshohet korniza ligjore me qëllim që qartë të përcaktohet mandati i komisioneve parlamentare dhe mekanizmave për mbikëqyrje. | Kuvendi, DSK. | 6 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Të ndryshohet korniza ligjore me qëllim që të precizohen obligimet e DSK në lidhje me komisionin parlamentar. | Kuvendi, DSK | 6 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Të sigurohet qasje tek baza e të dhënave nga ndjekja e komunikimeve brenda shërbimeve për nevojat e mbikëqyrjes së paralajmëruar dhe paparalajmëruar nga ana e organeve mbikëqyrëse. Emrat mos të jenë në dispozicion për kryerësit e mbikëqyrjes. | Kuvendi, MBP, AP, Drejtoria për mbrojtje të të dhënave personale | 9 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Të ndryshohet Kodi penal në mënyrë që obstrukcioni i mbikëqyrjes do të konsiderohet si vepër penale. | Kuvendi, MD | 9 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Përgatitja e planit vjetor për punë të Komisionit për mbikëqyrje mbi punën e zbatimit të masës së posaçme hetimore “ndjekje e komunikimeve” dhe “Komisioni për mbikëqyrje të punës së Drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim (DSK) dhe Agjencia për zbulim (AZ). | Kuvendi | 3 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|---|---|---|--------------|
| 7. | Përforsim i kontrollit mbi operatorët e telekomunikacionit, në pjesën e ndjekjeve të komunikimeve | <ul style="list-style-type: none"> Të mundësohet që komisionet kuvendore të kryejnë mbikëqyrje të operatorëve të telekomunikacionit. | Kuvendi | 6 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Vendosja e dënimeve më të rrepta për të punësuarit tek operatorët të cilët pa autorizim do të qasin ose do të mundësojnë qasje në meta-të dhëna ose në përmbajtje të komunikimeve. | Kuvendi, MShIA, MPB | 9 |
| 8. | Vendosjen e mbikëqyrjes shtesë qytetare / eksperte për mbikëqyrje të komunikimeve | <ul style="list-style-type: none"> Të hapet debat për vendosjen e mbikëqyrjes shtesë qytetare / eksperte për mbikëqyrje të komunikimeve. | Kuvendi, Kryetari i RM, MPB, AEK, bashkësia akademike | 6 |
| 9. | Përmirësim i transparencës së institucioneve shtetërore dhe operatorëve | <ul style="list-style-type: none"> Të vendoset detyrim ligjor për gjyqet (në nivel vjetor) të shpallin sa kërkesa kanë pranuar nga organet shtetërore për ndjekje të komunikimeve (metodë identike sikur tek PP), për sa persona ka pasur kërkesa, në çfarë baze dhe sa prej këtyre kërkesave janë refuzuar nga gjyqet. Të dhënat statistikore të shpallen jo më vonë se tre muaj pas kalimit të atij viti kalendarik. | Kuvendi, MD, Këshilli gjyqësor | 6 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Të vendoset si detyrim ligjor i operatorëve (në nivel vjetor) të shpallin të dhëna statistikore për numrin e urdhrave gjyqësor të pranuar dhe numrin e linjave telefonike të ndjekur. | Kuvendi, MD, MShIA, Këshilli gjyqësor | 6 |
| 10. | Edukimi i thelluar i institucioneve që kanë kompetenca në ndjekjen e komunikimeve | <ul style="list-style-type: none"> Të intensifikohen trajnimet e prokurorëve publik dhe gjykatësve për mbrojtje të së drejtës së privatisë dhe proporcionalitetit të zbatimit të masës "ndjekje të komunikimeve". | Akademia për gjykatës dhe prokuror publik | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Edukimi i të punësuarve në MPB, Ministrinë e mbrojtjes, Policinë financiare dhe Drejtorinë doganore për konceptin e mbikëqyrjes dhe llogaridhënies dhe rëndësisë së këtij koncepti për shoqërinë demokratike. | MPB, MM, Policia financiare, Drejtoria doganore | 6 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|---|--|--|--------------|
| 11. | Mbikëqyrje e përforcuar e punës së agjencive për siguri dhe (kundër) zbulim nga ana e mekanizmave të pavarur për kontroll | <ul style="list-style-type: none"> Në mënyrë proaktive të përdoren kompetencat e mekanizmave të pavarur për kontroll, për mbikëqyrje të punës së agjencive për siguri dhe (kundër)zbulim. | AP, DSK, drejtoria për mbrojtje të të dhënave personale. | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Zbatim i trajnimeve intensive për të punësuarit dhe punësim të personave profesional me qëllim që të fitojnë kapacitete të mekanizmave të pavarur të kontrollit (Avokati i popullit, Enti shtetëror për revizion, Drejtoria për mbrojtjen e të dhënave personale). | AP, DSK, drejtoria për mbrojtje të të dhënave personale. | 12 |

KUVENDI

Ndarja e pushtetit e përcakton rolin e rëndësishëm që gëzon Kuvendi në një shtet demokratik. Detyra e Kuvendit është të përcaktojë rrugën politike të shtetit, me anë të shqyrtimit, diskutimit dhe miratimit të ligjeve për të plotësuar rolin e saj ligjvënës. Gjatë viteve të fundit, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë ishte bërë shumë i varur nga pushteti ekzekutiv. Qeveria dhe ministrinë janë propozuesit më të mëdhenj të ligjeve, ndërsa Kuvendi funksionon vetëm si vërtetues i propozim-ligjeve, me çfarë zvogëlon rolin e saj ligjvënës. Përveç angazhimi modest në plotësimin e rolit të tij ligjvënës, Kuvendi nuk ka arritur të kryejë detyrën për të kontrolluar dhe mbikëqyrur punën e pushtetit ekzekutiv, duke e kufizuar në miratimin e vendimeve që janë në kundërshtim të interesit publik, dhe me atë nuk ka arritur të plotësojë detyrën për të përfaqësuar qytetarët e Republikës së Maqedonisë dhe zërin e tyre. Kjo ka kontribuar për dobësim të cilësisë së ligjvënies, pasigurisë ligjore, shkelje të parimit të ndarjes së pushtetit, ulje të rëndësisë së rolit kontrollues të Kuvendit dhe përgjegjësi e zvogëluar dhe transparencë të institucioneve.

Duke marrë parasysh kontekstin në të cilin gjendet Kuvendi dhe autoritetet tjera shtetërore, ky dokument përmban masat vijuese për përmirësim të rolit të Kuvendit. Në fillim, dokumenti përqendrohet në transparencën e punës së Kuvendit dhe përfshirje të publikut, pastaj fokusi transferohet në masat për përmirësim të kontrollit të Kuvendit. Masat në pjesën e tretë të matricës përqendrohen në procedurën e miratimit të ligjeve dhe efektivitetit, si dhe cilësisë së diskutimeve në Kuvend, ndërsa në fund mendohet për rolin e Kuvendit në procesin e integriteteve në BE.

Masat e propozuara për reforma të Kuvendit janë prioritete për procesin e demokratizimit të Republikës së Maqedonisë dhe theksimit të rolit kryesor të Kuvendit të RM.

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|---|---|--------------------------------|--------------|
| 1. | Rritje të transparencës së punës së deputetëve, me qëllim që në përgjithësi të rritet transparenca e Kuvendit | <ul style="list-style-type: none"> Plotësim i faqes së profilit për secilin prej deputetëve me telefon për kontakt dhe plotësim të informacioneve për biografinë e deputeteve; plotësim i faqes së profilit për secilin deputet, me histori të votimit për secilën pikë të rendit të ditës në të cilin ka marrë pjesë (sipas shembullit të Parlamentit Evropian); vendosja e informacioneve për shpenzimet e rrugës në faqen e profilit të deputeteve; evidencë për secilin deputet se për cilat pika ka marrë fjalë; vendosja e një lidhjeje drejt në fletën anketuese të deputetit nga ueb faqen e KShPK (shembull, Dhoma e Përfaqësuesve në Mbretërinë e Bashkuar dhe Kongresit në SHBA); evidencë e hapur për praninë e deputetëve të publikuar në faqen e profilit të tyre. | Kuvendi dhe shërbimi në Kuvend | 9 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Kontakte të deputetëve me qytetarët: Paralajmërim në internet faqen për atë se cili deputet ku dhe kur do të jetë i pranishëm në premtën, me qëllim që qytetarët që mund të marrin pjesë në takimet dhe vendosje e seksionit në ueb faqen "Pyeteni deputetin", në të cilin qytetarët do të mund të parashtrajnë pyetje deputetëve. Gjatë kësaj, pyetjet duhet të jenë qartë të dukshme. Ky seksion duhet të mundësojë qytetarët të mbështetnin ndonjë pyetje më para të parashtruar nga ndonjë qytetar tjetër, me çfarë çështje të caktuara me interes më të lartë publik mund të fitojnë më tepër mbështetje dhe të bëhet prioritare për përgjigje nga ana e deputetit ose deputetëve. Kuvendi, deputetët dhe grupet parlamentare. | Kuvendi dhe shërbimi në Kuvend | 9 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Vendosja e një ditari të përgjithshëm dhe kalendar të mbledhjeve të Kuvendit, që do të përmbajë informacione se cili deputet ka realizuar ose do të realizojë kontakte, cila është tema e mbledhjes, dhe informacionet e njëjta, varësisht nga deputeti, duhet të vendosen në faqen e profilit të deputetit (në çdo tre muaj). | Kuvendi dhe shërbimi në Kuvend | 9 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|--|---|---|-------------------|
| | | <ul style="list-style-type: none"> Hartimi dhe vendosja e një formulari të qartë për kërkesë për mbikëqyrje të seancës plenare ose seancës së trupit të punës dhe hartimi dhe vendosja e një formulari të qartë për kërkesë për pjesëmarrje në seancën e trupit të punës (Për dy pikat më lartë duhet të emërohet/shënohet adresa/personi zyrtar që do të pranojë kërkesën, theksohet afati në të cilën duhet të përgjigjet kërkesa, theksohet personi që do të veprojë me kërkesën dhe shënohet arsyetimi, nëse kërkesa refuzohet.) Përpilimi i një manuali në të cilën në mënyrë të qartë dhe thjeshtë, hap pa hapi, do të sqarohen gjitha fazat për mënyrën si qytetarët ose organizatat qytetare mund të fillojnë procedurë ligjore, si dhe vendet në njësitë zgjedhore ku duhet të mblidhen nënshkrimet. | <p>Kuvendi dhe shërbimi në Kuvend</p> <p>Kuvendi dhe shërbimi në Kuvend</p> | <p>9</p> <p>9</p> |
| 2. | Përforcimi i skemës programore të kanalit të Kuvendit në sajë të servisit publik radiodifuz, në drejtim të mundësisimit të informacioneve me kohë për orarin dhe seancat plenare dhe komisionet, si dhe transmetimi i tyre drejtpërdrejtë. | <ul style="list-style-type: none"> Sipas Nenit 35 të Ligjit për Kuvend, Këshilli i Kanalit të Kuvendit siguron transmetim të aktiviteteve të Kuvendit, me anë të servisit programor, dhe duhet të prezantohen dispozita në Ligjin për Kuvend që do të rregullojnë funksionimin e kanalit të Kuvendit dhe ueb faqen e Kuvendit në përputhje me parimet e theksuar në prioritetet. | Kuvendi dhe Këshilli i kanalit të Kuvendit | 9 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|---|---|--------------------------------|--------------|
| 3. | Shënimet stenografike të seancave të komisioneve duhet të jenë publike, nëpërmjet ueb faqes së Kuvendit, siç është për momentin e rregulluar për seancat plenare. Gjithashtu, përveç incizimeve të seancave plenare, në ueb faqen e Kuvendit duhet të jenë të gatshme edhe incizimet e seancave të komisioneve. | <ul style="list-style-type: none"> Ndryshim i Nenit 107 të Rregullores për Punë të Kuvendit të RM-së që të ketë publikim të detyrueshëm i shënimeve stenografike të debateve në komisione në ueb faqen e Kuvendit. | Kuvendi dhe shërbimi në Kuvend | 12 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Sipas Nenit 233 të Rregullores së Kuvendit të RM-së, Kuvendi ka ueb faqen në të cilën vendosen të dhëna të përgjithshme për Kuvendin, trupat e punës, kryetarin e Kuvendit, grupet parlamentare, delegacione të Kuvendit, ligjet e miratuara, seancat dhe aktivitete tjera të Kuvendit, për Shërbimin e Kuvendit dhe të dhëna tjera lidhur me organizimin dhe punën e Kuvendit. <p>Në këtë pjesë duhet të theksohet që përveç seancave plenare, Kuvendi ka për obligim të publikojë edhe incizimet e seancave të komisioneve.</p> <p>Gjatë kësaj, dispozicioni i video incizimeve në ueb faqen e Kuvendit nuk mund të kufizohet me përdorimin e një internet shfletues (Internet Explorer).</p> | Kuvendi dhe shërbimi në Kuvend | 12 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Dokumentet shoqëruese lidhur me propozim-ligjet (raporte, vlerësime të rregullores, analiza) duhet të vendosen në ueb faqen e Kuvendit dhe të mund të kërkohet me lehtësi. | Kuvendi dhe shërbimi në Kuvend | 9 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|---|--|--------------------------------|--------------|
| 4. | Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të RM-së duhet të përgatit një sistematizim të ri të shërbimit të Kuvendit, për të bërë më efikase, profesionale dhe të pajisur mirë me kuadro. | <ul style="list-style-type: none"> Përgatitja dhe miratimi i sistematizimit të ri të shërbimit të Kuvendit nga Sekretari i Përgjithshëm. | Kuvendi dhe shërbimi në Kuvend | 9 |
| 5. | Prezantimi i mekanizmit për kycje më thelbësore të palëve të interesuara, veçanërisht të sektorit qytetar, me anë të regjistrimit dhe akreditimit sipas fushave tematike. | <ul style="list-style-type: none"> Prezantimi i dispozitave në Rregulloren me të cilat do të themelohet dhe rregullohet regjistrimi dhe akreditimi i palëve të interesuara për pjesëmarrje në aktivitetet e Kuvendit. | Kuvendi | 12 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|--|--|-----------------------------|--------------|
| 6. | <p>Parashikimi i punës së Kuvendit premtori siguri më të madhe ligjore. Parashikim më i madh mund të arrihet në dy mënyra:</p> <p>Me prezantimin e orarit mujor ose tremujor për gjitha aktivitetet e Kuvendit, për të mundësuar kyçje më të lehtë të palëve të interesuara në procesin ligjvënës.</p> <p><u>Propozim alternativ:</u> Sipas Kushtetutës së RM-së, Kuvendi është në punë të vazhdueshme, por ka mundësi të punohet në cikle prej 6 javëve, prej të cilëve dy javët e para janë parashikuar për takime të trupave të punës (komisionet) dhe deputetët me njësitë e tyre dhe me palët e interesuara; dy javët vijuese janë parashikuar për punën e komisioneve, si përgatitje për seancat plenare, dhe dy javët e fundit janë parashikuar për seanca plenare. Cikli përsëritet menjëherë pas përfundimit të seancës së fundit plenare nga cikli paraprak.</p> | <ul style="list-style-type: none"> • Prezantimi i dispozitave në Rregullore që do të mundësojë krijim të orarit të rregullt mujor/tremujor për aktivitetet e Kuvendit dhe për zgjidhjen alternative me cikle prej 6 javëve. | Kuvendi | 12 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|---|---|-----------------------------|--------------|
| 7. | Debatet publike duhet të reformohen dhe të jenë të detyrueshme në fillim të çdo procesi ligjvënës. Për momentin, vendimi për nevojat e debateve publike është lënë në vullnetin e kryetarëve të komisioneve të Kuvendit. | <ul style="list-style-type: none"> Duhet prezantim i seksionit të veçantë në Rregulloren e Kuvendit të RM-së me të cilën debatet publike do të vendosen si të detyrueshme për fillimin e çdo procesi ligjvënës, ose plotësimin me nene të reja në seksionin e Trupave të Punës nga neni 117 deri në nenin 131 të Rregullores së Kuvendit të RM-së. | Kuvendi | 12 |
| 8. | Qasje publike në analizat e hartuara të Institutit Parlamentar. | <ul style="list-style-type: none"> Publikim në internet faqen e Institutit Parlamentar dhe ueb faqes së Kuvendit. | Institutit Parlamentar | 6 |
| 9. | Duhet të thjeshtësohet procedura për thirrje të debatit mbikëqyrës, gjegjësisht zhvillim të debatit mbikëqyrës mund të kërkojnë, dhjetë, në vend të pesëmbëdhjetë deputetëve. Kryetari i trupit të punës do të ketë për obligim menjëherë të thirr për debat mbikëqyrës. Gjithashtu, dëshmitarët dhe funksionarët e ftuar duhet detyrimisht të jenë të pranishëm në debatet mbikëqyrëse, nëse për atë kanë ftesë nga Kuvendi i RM-së. | <ul style="list-style-type: none"> Ndryshim i nenit 21, paragrafi 3 i Ligjit për Kuvend për të mundësuar debat mbikëqyrës të mund të kërkojnë 10 deputetë. | Kuvendi | 12 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Ndryshimi i nenit 20, paragrafit 4 të Ligjit për Kuvend, ku në vend të <i>kanë për obligim</i> do të qëndrojë <i>detyrimisht</i> ("Përfaqësuesit e ftuar kanë për obligim të marrin pjesë në seancën në të cilën do të zhvillohet debati mbikëqyrës"). | Kuvendi | 12 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|---|--|-----------------------------|--------------|
| 10. | Të gjithë funksionarët dhe përfaqësuesit e institucioneve duhet jenë të detyrueshëm të arsyetojnë raportet e tyre para Kuvendit, me qëllim të rritjes së llogaridhënies së këtyre institucioneve, dhe duhet të prezantohet edhe masa <i>shkarkim</i> të përfaqësuesve të institucioneve që nuk janë paraqitur dy herë në ftesë të Kuvendit. | <ul style="list-style-type: none"> Deputetët të kërkojnë përgjegjësi dhe dorëheqje nga funksionarë që refuzojnë (që nuk janë paraqitur dy herë në ftesë të Kuvendit) të paraqiten në dëgjimin në sajë të debateve të komisioneve në të cilët duhet të kryejnë obligimin për të arsyetuar raportet e tyre. Kjo mund të arrihet me anë të vendosjes së kornizës ligjore (ndryshime të rregullores – nene të reja në pjesën e trupave të punës 117-131) që do të stimulojë përgjegjësinë e udhëheqësve të institucioneve që nuk përgjigjen me prezencë pas ftesës nga Kuvendi. | Kuvendi | 12 |
| 11. | Raporte të çrregullta nga trupat rregullatore dhe mbikëqyrëse përgjegjëse për shqyrtimin e rasteve të mashtrimeve zgjedhore, klientizëm mediatik dhe korrupsion në nivel të lartë, duhet të prezantohen me kërkesë të Kuvendit. Kjo do të përforcojë rolin mbikëqyrës dhe kontrollues të Kuvendit ndaj këtyre trupave | <ul style="list-style-type: none"> Prezantimi i dispozitave të reja në Rregulloren e Kuvendit të RM-së me të cilat trupat rregullatore dhe mbikëqyrëse do të jenë të detyruar, me kërkesë të Kuvendit, të parashtrojë raporte të çrregullta kur shqyrtohen raste të mashtrimeve zgjedhore, klientizëm mediatik dhe korrupsion në nivel të lartë. | Kuvendi | 12 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|--|--|-----------------------------|--------------|
| 12. | Përforcimi i përbërjes së komisioneve të Kuvendit përgjegjës për kontrollin e DSK dhe MBP me ekspertë dhe përfaqësues të shoqërisë qytetare, në baza të barabarta. Kjo do të përforcojë profesionalizmin e këtyre trupave | <ul style="list-style-type: none"> Përforcimi i përbërjes së komisioneve të Kuvendit përgjegjës për kontrollin e DSK dhe MBP me ekspertë dhe përfaqësues të shoqërisë qytetare, në baza të barabarta. Kjo do të përforcojë profesionalizmin e këtyre trupave. | Kuvendi | 9 |
| 13. | Prezantimi i afateve të rrepta dhe pasoja për injorim të rekomandimeve ose të kërkesave të Kuvendit deri tek DSK dhe MPB. Kjo të qëndrojë në fuqi edhe për institucionet tjera që nënshtrohen kontrollit parlamentar | <ul style="list-style-type: none"> Prezantimi i afateve të rrepta dhe pasoja për injorim të rekomandimeve ose të kërkesave të Kuvendit deri tek DSK dhe MPB. | Kuvendi | 9 |
| 14. | Obligimi për pjesëmarrje në dëgjimet, të organizuar në kuadër të komisioneve anketuese, duhet të jetë i detyrueshëm. Gjithashtu, duhet të prezantohen mekanizma për njoftime nga komisionet anketuese (vendosja e incizimeve në uebfaqen e Kuvendit) | <ul style="list-style-type: none"> Vendosja e një kornize ligjore për komisionet anketuese në Rregulloren (në pjesën e dedikuar trupave të punës nga neni 117 deri neni 131), përfshirë edhe rregullimin e prezencës së detyrueshme të dëshmitarëve, fillimi i përdorimit të betimit për dëshmitarët dhe përcaktimi i relacionet mes hetimeve të Kuvendit dhe gjyqësorit. | Kuvendi | 12 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|--|--|-----------------------------|--------------|
| 15. | <p>Obligim që Kuvendi të shqyrtojë raportet vjetore të revizionit (EShR) dhe të miratojë konkluzione përkatëse mbi raportet. Raporte negative të revizionit Kuvendi duhet të përcjell në organet përkatëse dhe të kërkojë përgjegjësi të drejtë penale, ndëshkuese dhe politike. Vlen e njëjta edhe për Raportin Vjetor të trupave tjerë rregullatorë, përfshirë edhe Komisionin Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit (KShPK).</p> | <ul style="list-style-type: none"> Ndryshim i dispozitave të Ligjit për Revizion Shtetëror (nenit 33) dhe në Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit (neni 49), ku përveç obligimit të dorëzojnë raport, këto institucione do të nënshtrohen edhe përgjegjësisë përkatëse ndëshkuese, penale dhe politike para Kuvendit. Pas përmbylljes së debatit në komisionet përkatëse amë, ato janë të obliguar të miratojnë konkluzione përkatëse, të miratojnë ose jo raportet vjetore dhe të gjenden në rendin e ditës në seancën e parë vijuese plenare. | Kuvendi | 9 |
| 16. | <p>Prezantimi i kushtit për shumicë të dy të tretës për miratim të ligjeve me procedurë të shkurtër, si dhe lista të akteve që nuk mund të miratohen me procedurë të shkurtër.</p> | <ul style="list-style-type: none"> Ndryshimi i nenit 171 i Rregullores për të prezantuar kushtin për shumicë të dy të tretës për miratim të ligjeve me procedurë të shkurtër, si dhe lista të akteve që nuk mund të miratohen me procedurë të shkurtër. | Kuvendi | 12 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|---|--|-----------------------------|--------------|
| 17. | Nevojitet reformë të anëtarësisë së komisioneve të Kuvendit: zëvendësit e kryetarëve të trupave të punës duhet të jenë anëtarë të përhershëm të trupit. Për momentin, zëvendësit e kryetarëve shpesh nuk janë anëtarë të përhershëm të komisioneve me të cilët kryesojnë në mungesë të kryetarit. | <ul style="list-style-type: none"> • Plotësimi me nene të reja të Rregullores në pjesën e trupave të punës (nenet 117-131). | Kuvendi | 12 |
| 18. | Nga Rregullorja duhet të fshihet kufizimi që deputeti gjatë kontrollit mund të flet vetëm një herë. Gjithashtu, duhet të mundësohet paraqitje gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontrollit. | <ul style="list-style-type: none"> • Ndryshimi i nenit 80, paragrafit 2 me qëllim të largohet dispozita me të cilën rregullohet që deputetet paraqiten për fjalë në afat të një minute pas hapjes së kontrollit. Paraqitja për fjalë duhet të mundësohet gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontrollit. • Ndryshim i nenit 86, paragrafit 1 me qëllim të largimit të kufizimit që deputeti gjatë kontrollit mund të flet vetëm një herë. Paraqitja e dytë për diskutim për pikën e njëjtë të rendit të ditës për deputetin është 5 minuta, ndërsa e para mbetet 10 minuta, dhe 15 minuta për koordinatorin e grupit parlamentar ose propozuesit të autorizuar. | Kuvendi | 12 |
| | | | Kuvendi | 12 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|---|---|-----------------------------|--------------|
| 19. | Prezantimi i seancës për pyetje deputetësh që do të zhvillohet dy herë në muaj dhe vazhdim i kohës së parashtrimit të pyetjeve për deputetët. | <ul style="list-style-type: none"> Ndryshim i nenit 39, paragrafit 1 të Rregullores për të prezantuar seancë për pyetje deputetësh që do të zhvillohet dy herë në muaj. | Kuvendi | 12 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Ndryshim i nenit 39, paragrafit 5 të Rregullores me qëllim të mundësohet parashtrimi i pyetjeve për deputetë të zgjat deri më pesëmbëdhjetë minuta, ndërsa deputeti ka të drejtë të deklarohet nëse është i kënaqur nga përgjigja deri më pesë minuta. | Kuvendi | 12 |
| 20. | Rritje e transparencës së procedurës buxhetore, me anë të ndryshimit të Rregullores në pjesën e miratimit të buxhetit, në drejtim të rritjes së gatishmërisë së gjitha informacioneve që janë relevante për buxhetin. | <ul style="list-style-type: none"> Rritje e transparencës së procedurës buxhetore, me anë të ndryshimit të Rregullores në pjesën e miratimit të buxhetit, në drejtim të rritjes së gatishmërisë së gjitha informacioneve që janë relevante për buxhetin. | Kuvendi | 12 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Rritje të kohëzgjatjes së debateve buxhetore me qëllim të shqyrtohet gjitha amendamentet, me ndryshim në nenit 180-a, paragrafit 1 të Rregullores së Kuvendit të RM, me çfarë në vend të 10 ditëve, për buxhetin do të mund të diskutohen 15 ditë pune. | Kuvendi | 12 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Rritje e transparencës së procedurës buxhetore me anë të publikimit të buxhetit të fundit të miratuar dhe raportet gjashtë mujore për realizimin/shpenzimin e buxhetit. | Kuvendi | 12 |
| 21. | Përcaktim i qartë i procedurës parlamentare në procesin e shqyrtimit dhe miratimit të llogarisë përfundimtare të buxhetit. | <ul style="list-style-type: none"> Përcaktim i qartë i procedurës parlamentare në procesin e shqyrtimit dhe miratimit të llogarisë përfundimtare të buxhetit në Rregulloren e Kuvendit të RN në pjesën e dedikuar procedurës për miratimi ne buxhetit të Republikës së Maqedonisë dhe llogarisë përfundimtare të buxhetit. | Kuvendi | 12 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|---|--|-----------------------------------|--------------|
| 22. | Përforcim i rolit të Këshillit Buxhetor për të siguruar pavarësi më e madhe e Kuvendit nga pushteti ekzekutiv gjatë përgatitjes së buxhetit vjetore të Kuvendit | <ul style="list-style-type: none"> Projektimi buxhetor i Këshillit Buxhetor të merret në tërësi parasysh gjatë përgatitjes së propozim-buxhetit të shtetit. | Kuvendi dhe Ministria e Financave | 12 |
| 23. | Aktivitete që kanë të bëjnë me përforcimin e rolit të Kuvendit në proceset e integrimi në BE. | <ul style="list-style-type: none"> Kontrrolli i përputhjes së propozim akteve ligjore me ligjvënien evropiane (acquis communautaire) nga ana e Komisionit për Çështje Evropiane (KÇE) në fazën përfundimtare ligjvënëse. Prezantimi i një regjistri on-line të ligjeve me flamur evropian, që të mund më lehtë të kërkohen në ueb faqen e Kuvendit. Kompetenca qartë të përcaktuar të KÇE dhe Këshillit Kombëtar për Integrimi Evropiane (KKIE), të mos ketë përputhje të kompetencave dhe shfrytëzim maksimal i kapaciteteve të KKIE për përforcim të rolit të KÇE në pjesën e mbikëqyrjes dhe avancimit të harmonizimit ligjor. | Kuvendi | 9 |
| | | | Kuvendi | 9 |
| | | | Kuvendi | 9 |

SHOQËRIA QYTETARE

Për momentin, shoqëria qytetare është në pritje të ndryshimeve në drejtim të përparimit të gjendjeve, si në procesin e krijimit të politikave, ashtu edhe në procesin politik. Në veçanti është përvoja negative me kontrollin e bazuar politike të shoqërisë qytetare (a.q. de-sorosiozim) që kanë filluar pak para zgjedhjeve të fundit parlamentare në dhjetor të vitit 2016 dhe kjo bazë nuk është e vendosur dhe paraqet një formë të persekutimit institucional mbi OJQ-të. Paraqiten iniciativa të caktuara qytetare për kyçje dhe konsultime. Ka një nevojë të madhe për krijimin e një rrethine që mundësin për shoqërinë qytetare, për themelimin e një financimi relevant (të bazuar në nevoja), transparent dhe përgjegjës publik të shoqërisë qytetare edhe zhvillimin përkatës. Duhet përmirësim i një pjese të madhe të mekanizmave aktuale dhe praktika për konsultim të shoqërisë qytetare dhe për pjesëmarrje thelbësore qytetare, si në nivelin bazë, ashtu edhe në nivelin e politikave, me çfarë do të rritet ndikimi mbi institucionet dhe do të avancohen proceset e krijimit të politikave.

Pjesëmarrja qytetare në procesin e krijimit të politikave dhe procesin politik duhet të përmirësohet me anë të: zbardhje të persekutimit institucional të përfaqësuesve të sektorit qytetar; themelimi i një këshilli të pavarur dhe përfaqësues për bashkëpunim me organizatat qytetare; për themelimin e një financimi relevant (të bazuar në nevoja), transparent dhe përgjegjës publik të shoqërisë qytetare edhe zhvillimin përkatës; miratimi i Strategjisë së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për bashkëpunim me sektorin qytetar për periudhën 2018-2021, si dhe plane vjetore veprimi, me anë të një procesi në të cilin në mënyrë aktive do të merr pjesë shoqëria qytetare; rritja e kompetencave të Departamentit për Bashkëpunim me Organizatat Qeveritare në Sekretariatit e Përgjithshëm dhe ngritja e kapaciteteve në drejtim të krijimit të një rrethine pozitive për shoqërinë qytetare; garanci për pjesëmarrje të qytetarëve në procese konsultimi; ndryshime të ligjeve përkatëse, me qëllim që të zvogëlohet pragjet për referendum, initiative ligjore dhe peticion; të ndryshohet rregullorja për funksionim të pavarur të OJQ-ve dhe mundësi të barabarta të OJQ-ve; revizion i rregullores ligjore për ngarkime tatimore të shoqatave dhe organizatave (saktësim i statusit); mundësim i kushteve më të mira për angazhim në OJQ, praktikë, vullnetari dhe punë e të rinjve, si dhe sigurimi i kornizës ligjore për të drejtën e mbledhjes së qetë, në përputhje me standardet ndërkombëtare, dhe sigurim i zbatimit përkatës efektiv.

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|---|--|--|--------------|
| 1. | Zbardhim të persekutimit institucional mbi sektorin qytetar | <ul style="list-style-type: none"> • Ndërprijtje të hetimeve të fiksuara politike dhe kontrollit mbi organizatat qytetare (a.q. desoroizim). • Identifikim të inspirimit, dhënësit e urdhrave dhe zbatuesit e këtij persekutimi politik të organizatave qytetare nga ana e institucioneve shtetërore. • Analizë e bazës dhe përgjegjësisë së persekutimit të orkestruar institucional të OJQ-ve. • Analizë dhe përcaktim të keqpërdorimit të detyrës zyrtare nga dhënësit e urdhrave dhe zbatuesit. | Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KShPK), Prokuroria, Drejtoria për të Ardhura Publike (DAP), Policia Financiare, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Kuvendi, Agjencia për Kundërzbulim Financiar | 3 |
| 2. | Themelimi i një këshilli të pavarur dhe përfaqësues për bashkëpunim me organizatat qytetare | <ul style="list-style-type: none"> • Anullim të vendimit • Konsultime për miratim të vendimit të ri për këshill, në bashkëpunim të plotë me OJQ, dhe në lidhje me strukturën e Këshillit, kriteret, si dhe organizimi dhe zbatimi i zgjedhjes. • Organizimi i zgjedhjeve me respektimin e rekomandimeve të organizatave qytetare. • Krite për përfaqësim | Sekretariati i Përgjithshëm, Sekretariati për Çështje Evropiane (SÇE) | 3 |
| 3. | Themelimi i një financimi relevant (të bazuar në nevoja), transparent dhe përgjegjës publik të shoqërisë qytetar edhe zhvillimin përkatës | <ul style="list-style-type: none"> • Shpallje të moratoriumit për shpërndarjen e mjeteve financiare të OJQ nga Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë deri në miratimin e procedurave dhe kriterëve të qarta për financim shtetëror të organizatave qytetare./ • Publikim i gjitha raporteve dhe vlerësimeve për aktivitetet e zbatuara dhe mjetet e realizuara të dhënë OJQ-ve në nivel kombëtar dhe nivel lokal gjatë 5 viteve të fundit, si dhe mbështetje tjetër financiare dhe jo-financiare, për shembull, përdorimi i hapësirave publike dhe mjete tjera (automjete zyrtare). • Ndryshimi i nenit 16 të Ligjit të Lojërave të Fatit dhe Lojërave Argëtuese (prezantim i thirrjes së detyrueshme publike për shpërndarjen e mjeteve dhe vlerësim të mjeteve të shpenzuara, me mundësi që organizatat qytetare të marrin pjesë në konkurset). • Prezantim analitik të linjës buxhetore 463 deri më 6 shifra në lidhje me transferimet ndaj organizatave qytetare dhe fondacioneve nëpërmjet ministrive dhe agjencive, si dhe transferimet ndaj partive politike dhe organizatave tjera. | Ministria e Financave (MF), Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale (NJVL), rajonet e planifikimit dhe Qeveria dhe organet e saja, trupat rregullatore, agjencitë, ndërmarrjet publike | 3 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|--|---|---|--------------|
| 4. | miratimi i Strategjisë së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për bashkëpunim me sektorin qytetar për periudhën 2018-2021, si dhe plane vjetore veprimit, me anë të një procesi në të cilën në mënyrë aktive merr pjesë shoqëria qytetare | <ul style="list-style-type: none"> • Hartimi dhe krijimi i një baze me të dhëna për gjendjen aktuale me OJQ, numri i organizatave të regjistruara sipas llojit dhe formës së veprimit, statusit të aktivitetit, veprimtarisë, rajonit gjeografik dhe sigurimi i qasjes publike për ato. (Në këtë kuptim, duhet të bëhet pastrim i bazës aktuale me të dhëna nga regjistri i OJQ-ve, krijimi i një regjistri unik për organizatat qytetare sipas LShFF 2010 dhe anulim të regjistrimit sipas LShQF të parë). • Fillimi i një procesi të gjerë të konsultimit për një strategji të re me pjesëmarrje të drejtë dhe thelbësore të organizatave qytetare në fazën më të hershme dhe pjesëmarrje të institucioneve përkatëse kompetente. • Zhvillimi i sistemit përkatës për monitorim dhe vlerësim të strategjisë, si dhe sigurimi i mjeteve përkatëse financiare për zbatim në secilën prej institucioneve të kyçura. • Përcaktim i rolit të OJQ-ve si dhe të termit "rrethinë e vulltshme" në kuptimin më të gjerë për organizatat qytetare • Mbështetje të rrjeteve aktuale efektive tematike të organizatave të qytetarëve (Platforma për Kundër Korrupsion, IPA 2 mekanizëm për organizata qytetare, Rrjeti 23, Këshilli Kombëtar Rinor, Platforma për Barazi Gjinore, Platforma kundër Varfërisë, Këshilli Kombëtar për Barazi Gjinore, etj.) si dhe bashkëpunim për transparencën e mëtutjeshme të tyre dhe hapje ndaj anëtarëve të rinj. | Sekretariati i Përgjithshëm, SÇE, Regjistri Qendror | 6 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|--|---|---|--------------|
| 5. | Rritja e kompetencave të Departamentit për Bashkëpunim me Organizatat Qeveritare në Sekretariat e Përgjithshëm dhe ngritja e kapaciteteve në drejtim të krijimit të një rrethine pozitive për shoqërinë qytetare | <ul style="list-style-type: none"> Avancimi i statusit të departamentit të deritanishëm në zyrë të pavarur në sajë të Sekretariatit të Përgjithshëm të Qeverisë, themelimi i strategjisë efektive komunikimi me organizatat qytetare/personat për kontakt në ministritë përkatëse. Mbështetje për Këshillin për Bashkëpunim me Organizatat Qytetare (Sekretariati) dhe plotësim i Strategjisë, vlerësimi dhe përgatitja e strategjisë së re/përfshirje e masave strategjike në fushën e qëndrueshmërisë financiare (për shembull, lirim tatimor për personat fizik, donacione korporatave, statusi i interesit publik, aktivitete ekonomike, krijimi i të ardhurave, vullnetarizëm). Sigurimi i një buxheti të pavarur me qëllim që Zyra të mund të zbatoj detyrat me kohë dhe pavarësisht. | Sekretariati i Përgjithshëm, SÇE | 6 |
| 6. | Garanci për pjesëmarrje të qytetarëve në procese konsultimi | <ul style="list-style-type: none"> Diskutime publike dhe debate me OJQ sektorial Njohje dhe garanci të mekanizmave konsultimi me organizatat qytetare dhe trupat përfaqësuese, si: IPA Mekanizmi për Organizata Qytetare, KRKM, KLR, Parlamenti Studentor, komunitetet e shkollave të mesme, etj. Duhet të garantohet përfshirje të organizatave qytetare në procesin e miratimit të vendimeve dhe krijimit të politikave në fazën më të hershme të procesit. | Qeveria, komisionet e Kuvendit, Bashkësia e NJVL, NJVL, Ministria e Drejtësisë (MD) | 9 |
| 7. | Ndryshime të ligjeve përkatëse, me qëllim që të zvogëlohet pragjet për referendum, iniciative ligjore dhe peticion | <ul style="list-style-type: none"> Hapje të një procesi të konsultimit për miratim të një ligji të ri për referendum dhe forma tjera të shprehje të drejtë të qytetarëve, si dhe qasje në institucione gjatë regjistrimit të qytetarëve që dëshirojnë të praktikojnë këto forma të demokracisë së drejtpërdrejtë. Sigurimi i mundësisë që zyrat rajonale të KShZ të mbledhin nënshkrime për referendum lokal nëpër hapësira publike (për shembull, sheshe). Vlerësim dhe nëse e nevojshme, revizion të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, për të siguruar mekanizma plotësues për demokraci të drejtpërdrejtë, përfshirë edhe përfaqësues të shoqërisë qytetare në këshillat, përgatitje të strategjive lokale për bashkëpunim me shoqërinë qytetare (bashkë me organizatat qytetare) dhe sigurim të mbështetjes financiare dhe tjetër për këto iniciativa. Fushatë masive dhe interaktive për informim të qytetarëve për mundësitë e pjesëmarrjes dhe njëherë stimulim të aktivizmit | MD, MF, Kuvendi, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, NJVL | 6 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|--|--|-----------------------------|--------------|
| 8. | Të ndryshohet rregullorja për funksionim të pavarur të OJQ-ve dhe mundësi të barabarta të OJQ-ve, përcaktim i rregullores tatimore dhe kontabilitet për OJQ-të | <ul style="list-style-type: none"> • Ndryshim dhe avancim i kornizës ligjore që rregullon punën e shoqatave dhe fondacioneve (rregulloren tatimore, Ligjin për Kontabilitet të OJQ-ve, njohja e statusit të iniciativave joformale, rrejet, si dhe revizion dhe saktësim i nenit 13 të LShF, veprim jopartiak, si dhe largim të përfaqësuesve të autorizuar të OJQ nga përcaktimi i personave zyrtar të dhënë në nenin 122, paragrafin 4 të Kodit Penal). • Miratimi i Ligjit për Ndërmarrje Sociale, në proces konsultimi me OJQ-të. • Avancimi i politikave për punësim në sektorin qytetar me anë të mundësimit të përdorimit të mjeteve për mbështetje që vlejné për gjithë sektorët tjerë. | MD, Kuvendi | 6 |
| 9. | Revizion i rregullores ligjore për ngarkime tatimore të shoqatave dhe organizatave (saktësim i statusit) | <ul style="list-style-type: none"> • Fillimi i një procesi të gjerë të konsultimit për revizion të kornizës tatimore dhe fiskale për punën e organizatave qytetare. Në këtë drejtim, duhet të bëhen ndryshime përkatëse në Ligjin për Tatim Personal, Tatim i Përfitimit, TVSH (për pragun e subjekteve të vogla), Ligjit të për Donacione dhe Sponsor në Veprimtaritë Publike, Ligji për Kontabilitet në Sektorit Joprofitabil dhe të parashikohen përfitimet tatimore që dalin nga Ligji për Shoqata dhe Fondacione. Duhet të saktësohet rregullorja tatimore për organizatat joprofitabile dhe të bëhet një dalim i qartë i statusit mes OJQ-ve dhe shoqërive tregtare. • Të shmanget dy-kuptimi gjatë interpretimit dhe zbatimit të ligjeve nga ana e institucioneve shtetërore. • Lirime tatimore (TVSH) për pjesën e bashkë-financuar të projekteve të aprovuar dhe mbështetur nga donatorët (BE, SHBA, shtetet anëtare të BE-së dhe shtetet që janë nënshkruese të marrëveshjeve për bashkëpunim bilateral), në fushën e pjesëmarrjes së OJQ-ve me bashkë-financim (si dhe procedura për lirim tatimor për donacione dhe sponsor në Ministrinë e Drejtësisë). • Ka nevojë për ulje të konsiderueshme të kohëzgjatjes së procedurës për regjistrim të projekteve në Sekretariatit për Çështje Evropiane. | MF, MD, SÇE, Kuvendi | 9 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|---|---|--|--------------|
| 10. | Mundësim i kushteve më të mira për angazhim në OJQ, praktikë, vullnetari dhe punë e të rinjve | <ul style="list-style-type: none"> • Revizion i legjislaturës për vullnetarizëm dhe praktikë. • Thjeshtësim dhe lehtësim të procedurës për paraqitjen e vullnetarëve të huaj. • Krijimi i kornizës ligjore për profesion rinor dhe njohja përkatëse. | Ministria e Punës dhe Politikës Sociale (MPPS), Agjencia për të Rinj dhe Sport (ARS), MPB, Këshilli për Vullnetari, Agjencia e Punësimit të RM, QAR | 9 |
| 11. | Themelimi i një financimi relevant (të bazuar në nevoja), transparent dhe përgjegjës publik të shoqërisë qytetar edhe zhvillimin përkatës | <ul style="list-style-type: none"> • Themelimi i një fondi për bashkë-financim (në sajë të institucioneve aktuale shtetërore, si Fondi Kombëtar, SFQNM), projekte të OJQ-ve të mbështetur nga donatorët (BE, SHBA, shtetet anëtare të BE-së dhe shtetet që janë nënshkruese të marrëveshjeve për bashkëpunim bilateral) si dhe krijimi i Fondit Garantues për sigurim të mjeteve për bankat të synuar për kredi pa interes për financim të projekteve. • Reformë të modelit aktual të financimit publik të OJQ-ve në nivel qendror dhe lokal (me ndarjen e shoqatave dhe fondacioneve në linjë të veçantë buxhetore). • Revizion dhe miratim të propozim vendimit për shpërndarje të mjeteve publike të synuar për financim të aktiviteteve programuese të organizatave qytetare dhe fondacione të vitit 2016, linja buxhetore 463), si dhe përcaktim të procedurës së qartë dhe kritere për shpërndarjen e mjeteve (financim shumëvjeçar dhe financim institucional, projekte dhe bashkë-financim të projekteve të aprovuar nga BE me anë të kontributit nga IPA. | MF, Fondi Kombëtar, Sekretariati për Çështje Evropiane, Sektori për Financim Qendror dhe Nënshkrim të Marrëveshjeve (SFQNM), Sekretariati i Përgjithshëm | 12 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|---|---|-----------------------------|--------------|
| 12. | Sigurimi i kornizës ligjore për të drejtën e mbledhjes së qetë, në përputhje me standartet ndërkombëtare, dhe sigurim i zbatimit përkatës efektiv | <ul style="list-style-type: none"> • Revizioni i Ligjit për Mbledhje Publike, Ligjit për Polici dhe Ligjit për Rend dhe Qetësi Publike, si dhe legjislaturës tjetër që mbulon këto çështje. Krijimi i akteve nënligjore për respektimin e të drejtave të njeriut, veçanërisht për tejkalimin e autorizimeve dhe përdorimit të forcës së tepruar. Krijimi i mekanizmave për mbikëqyrje të pavarur të brendshëm dhe të jashtëm mbi policinë, me përfshirjen e faktorëve jo-shtetëror. • Ndjekje të përparimit në zbatimin e masës për themelimin e zonjës neutrale rreth ndërtesës së Kuvendit të RM në Planin për Aktivitete të Qeverisë (pika 4.1.), i përgatitur në bazë të Prioriteteve Urgjente Reformuese për RM, dhe drejtim të kufizimeve të mundshme të së drejtës për mbledhje të qetë. • Përforcimi i kapaciteteve të institucioneve dhe policisë për zbatim të plotë dhe të drejtë dhe respektim të së drejtës së mbledhjes nga ana e institucioneve dhe policisë, veçanërisht në raste të mbledhjes së qetë. Këtu në veçanti bëhet fjalë për kapacitetet e institucioneve dhe policisë për përdorimin përkatës së forcës, me qëllim të ruajtjes së rendit publik dhe qetësisë, përfshirë edhe përgatitje të drejtimeve dhe trajnimeve të bazuar në Rekomandimet Praktike për Menaxhim të Mbledhjeve nga njoftuesit special të OKB, Maina Kiai dhe Kristof Hejns (A/HRC/31/66), mars 2016. | Qeveria, MPB, MD | 12 |

MBROJTJA SOCIALE, MIRËQENIA DHE QËNDRUESHMËRIA

Krijimi i një sistemi bashkëkohor, i qëndrueshëm dhe funksional i mbrojtjes sociale, që do të përgjigjet nevojave të përdoruesve është një sfidë për Republikën e Maqedonisë që prej pavarësisht në vitin 1991. Problemet sociale që ka imponuar (dhe ende imponon) procesi i tranzicionit, kanë sjellë në rritje të numrit të personave të papunësuar, rënie të standardit të jetës, zvogëlim të produktit të brendshëm bruto, dhe rritje të numrit dhe kategorive të personave të cenuar social.

Për mbrojtje efikase të të drejtave sociale të qytetarëve dhe realizimi i dispozitës kushtetuese të Republikës së Maqedonisë si shtet social, duhet përqendrim për krijimin e një kornize normative stabile që do të sigurojë mbrojtje efektive dhe mirëqenie për gjithë qytetarët. Duhet politika plotësuese që nuk do të jenë vetëm për kënaqjen e nevojave minimale të jetës së qytetarëve, por edhe masa për mundësi të barabarta për pjesëmarrje aktive të gjithë faktorëve në proceset shoqërore.

Andaj, si prioritet theksohet nevoja për miratimi e Ligjit për Mbrojtje Sociale të ri (në periudhë prej 12 muajve) me pjesëmarrjen e siguruar të gjithë aktorëve relevant në procesin, veçanërisht të qytetarëve në rrezik social dhe organizatat qytetare. Ligji duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe inkluziv, me përcaktues të qartë të gjitha kategorive të cenuar, si dhe relacione inovative në lidhje me gjitha rreziqet e pacaktuara ose panjohura sociale dhe shërbimet e nevojshme sociale.

Në këtë drejtim, matrica e këtij dokumenti ofron zgjidhje ideale për krijimin e politikave të qëndrueshme dhe të ndjeshme gjinore në fushën e mbrojtjes sociale. Në kohën e njëjtë, jep edhe një pasqyrë të prioriteteve dhe masave thelbësore, që me realizimin e tyre urgjent, Qeveria e Republikës së Maqedonisë do të mundësojë kushte për jetë me dinjitet për gjithë qytetarët.

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|--|--|--|--------------|
| 1. | Tejkalimi i barrierave administrative në qasjen e transferimeve sociale dhe shërbimeve sociale, në periudhën deri në miratimin e ligjit të ri për mbrojtje sociale | <ul style="list-style-type: none"> • Miratimi i rregullores me të cilën do të mundësohet aplikim për transferime sociale për personat e bllokuar për shkak të marrjes së mjeteve me transferim të shpejtë të të hollave. • Revizion urgjent i lidhjes teknike të secilit prej numrave sociale me MPPS, QPS dhe bankat. • Gjetje e zgjidhjes për personat që kanë rënë në probleme financiare dhe nuk mund të hedhin kompanitë e tyre në falimentim (problemi është shumë-dimensional - nuk kanë mjete, dhe kanë shpenzime të mëdha për në gjykatë, kontributet ju rrjedhin, dhe nuk mund të paguajnë, nuk mund të ç'lajmërohen nëse janë drejtues dhe nuk mund të paraqiten si të papunë, dhe nuk kanë të drejtë për shëndetësi dhe asnjë të drejtë). • Revizion i procedurave për realizim të drejtave të pa punësimit dhe shërbimeve sociale dhe të drejtat e personave që janë themelues të shoqatave, organizatë qytetare ose themelues të kompanive, por nuk janë të punësuar në ato. | Ministria e Punës dhe Politikës Sociale (MPPS), qendrat për punë sociale (QPS), bankat, Agjencia e Punësimit të RM-së (APRM) | 3 |
| 2. | Vlerësim i zbatimit të rregullores nga fusha e mbrojtjes sociale | <ul style="list-style-type: none"> • Analiza e strategjive kombëtare (për mbrojtje sociale, ulje të varfërisë dhe përjashtimit social, për ç'insitucionalizim) sipas metodologjisë së caktuar të Qeverisë së RM. • Hartimi i planeve të veprimit për vitin 2018, në përputhje me strategjitë, implikimet buxhetore dhe qasjes participative. | MPPS, Enti për Veprimtari Sociale (EVS), QPS, entet publike, qendrat ditore | 9 |
| 3. | Reformë e procesit të licencimit në sistemin e mbrojtjes sociale | <ul style="list-style-type: none"> • Të bëhet ndryshim dhe plotësim i Rregullores për Licencim të Punëtorëve Profesional dhe dhënësve të shërbimeve. • Të bëhet licencim i dhënësve të shërbimeve që realizojnë veprimtari me interes publik dhe japin shërbime në fushën e mbrojtjes sociale. • Të përcaktohen protokolle për standarde minimale për dhënie të shërbimit social. • Të bëhet revizion dhe avancim i moduleve për trajnim të punëtorëve profesional. • Në komisionin për licencim të përfshihen edhe përfaqësues të organizatave qytetare. | MPPS, EVS, Institucione të arsimit të lartë | 6 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|--|--|--|--------------|
| 4. | Trans-formim i sistemit të përfitimeve në të holla | <ul style="list-style-type: none"> • Të bëhet revizion i kriterëve aktuale dhe marrës të përfitimeve në të holla dhe të merret parasysh aspekti gjinor • Të bëhet vlerësim i mundësisë për prezantim të shumës minimale adekuatë (analizë e përfitimit të kostove) dhe të hartohet një metodologji e re për shfrytëzimin e të drejtës për mbrojtje sociale, në përputhje me rezultatet. • Të bëhet automatike transferimi nga një kategori në tjetër për realizimin e ndonjë të drejte. | MPPS, Ministria e financave (MF), QPS | 12 + |
| 5. | Hartimi social dhe zgjerimi i shërbimeve sociale në nivel lokal, sipas nevojave të vërteta të grupeve të cenuar social | <ul style="list-style-type: none"> • Të përpilohen hartë sociale për secilën NJVL dhe të mundësohet qasje elektronike • Të bëhet një analizë dhe të bëhet përfshirje e aspekteve gjinore në shërbimet sociale. • Të decentralizohen shërbimet sociale sipas nevojave të drejtpërdrejta të qytetarëve • Të mundësohet realizim të pluralizmit social me anë të sigurimit të mjedisit të volitshëm ligjor për marrëveshje sociale dhe rritje të resurseve për parandalim social dhe mbrojtje në komunitet. • Të bëhet standardizim i shërbimeve për mbrojtje sociale dhe të prezantohet mekanizëm (ligjor ose nënligjor) për akreditim të organizatave qytetare për ofrim të shërbimeve të drejtpërdrejta në fushën e mbrojtjes sociale. • Të njihet përfshirja e organizatave qytetare, si dhënës të drejtpërdrejtë të shërbimeve në fushën e mbrojtjes sociale, me anë të marrëveshjeve sociale. • Të bëhet ç’institucionalizim urgjent dhe të sigurohet respektim i të drejtave të njeriut për personat e vendosur në institucione, në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Ç’instituonalizim. • Të pranohet në mënyrë formale-ligjore PRIDE – metodologjia për përgatitje, trajnim dhe përfshirje të kujdestarëve në sistemin e kujdesit të fëmijëve për fëmijët pa kujdes prindëror, me qëllim të përforcimit të sistemit të mbrojtjes sociale. | MPPS, QPS, APRM, MF, Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale (NJVL), organizatat qytetare, institucionet akademike | 12 + |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|---|---|-----------------------------|--------------|
| 6. | Trans-formimi i tregut të punës në inkluziv | <ul style="list-style-type: none"> • Programi operativ për masa aktive për punësim të përbajë masa të ndjeshme dhe inkluzive për punësim • Të maten efikasiteti dhe efektiviteti i masave aktive për punësim të personave në rrezik social dhe të bëhet avancimi i tyre në për-puthje me nevojat e qytetarëve. • Prezantimi i mbështetjes dhe mentorimit për përdoruesit e masës për vetë-punësim, për periudhë prej së paku një vit • Masat për aktivizim (masat aktive për punësim) të dizajnohen me kujdes, të parashikojnë masa specifike për kategoritë e cenuar dhe të synojnë kategori specifike, por edhe të zbatohen në grupe më të vogla. • Të bëhet lidhje elektronike mes QPS dhe APRM për identifikim më të lehtë dhe qasje në grupet më të cenuar. | MPPS, , QPS, APRM | 6 |
| 7. | Kycje aktive të kategorive të cenuar social | <ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i mekanizmit për aktivizim efektiv në tregun e punës për marrësit e ndihmës sociale dhe grupeve tjera në rrezik social, me anë të monitorimit të rezultateve. • Sigurimi i procesit të detyrueshëm të ri-integrimit të punës për personat në rrezik social para se të fillohet me përdorimin e masave për punësim. • Të mundësohet zhvillimi i sipërmarrjes funksionale sociale (miratimi i Ligjit për Sipërmarrje Sociale, si prioritet). • Kombinimi i masave për aktivizim me transferimet sociale në të holla për pësonin në rrezik dhe mbështetje e detyrueshme psike-sociale gjatë vitit të parë. • Prezantimi i masave dhe mekanizmave për rritje të vetëdijes tek kategoritë e cenuar për masat aktuale për aktivizim, motivimi i tyre për të integruar dhe tejkaluar frika nga humbja e ndihmës sociale. | MPPS, QPS, APRM, MF | 9 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|---|--|---|--------------|
| 8. | Hartimi dhe promovimi i statistikave publike dhe të ndarë sipas gjinisë | <ul style="list-style-type: none"> • Përputhje dhe zgjerim të treguesve për mbledhjen e statistikave sociale. • Sinkronizim i regjistrave – pasqyrë on-line dhe përditësim i rregullt. | MPPS (PZMS, tjera), EVS (Lirikus), Sigurimi Pensionsal dhe Invalidor i Maqedonisë, APRM, organizata qytetare dhe organizata ndërkombëtare | 9 |

ARSIMI DHE POLITIKAT RINORE

Reformat në arsimin, trajnimin dhe të rinjtë duhet të drejtohen kah rritja e përfshirjes së fëmijëve në arsimin parashkollor, përmirësimin e kualiteti të sistemeve për sigurimin e cilësisë në të gjitha shkallët dhe llojet e arsimit, si dhe drejt përmirësimit të inkluzionit arsimor (veçanërisht e fëmijëve të cilët largohen shumë herët nga sistemi arsimor, fëmijët me arritje të ulëta, romët, fëmijët e grupeve të cenushme, fëmijë me nevoja të veçanta arsimore etj.). Më së voni deri në fund të 2017, duhet të miratohet një Strategji e re gjithëpërfshirëse për arsim me kornizë kohore të vazhduar, e cila do të jetë rezultat i konsultimeve të gjera me të gjitha palët e prekura. Është i domosdoshëm të fillohet procesi i reformës serioze kurikulare tek e cila do të jenë të përfshirë ekspertë dhe praktikantë dhe që do të bazohet në praktikën e mira Evropiane, e cila do të synojë kah arritjet e rezultateve nga mësimi i përcaktuar me standardet nacionale për çdo cikël arsimor, si dhe drejt nxitjes së të menduarit kritik të nxënësit, respektimi i të drejtave njerëzore, vlerave demokratike, integritit ndëretnik, barazisë gjinore dhe respektimi i diversitetit. Propozojmë të miratohet Ligj për arsim parashkollor; të tërhiqet Ligji për akademinë për arsimtarë, si dhe të reformohet arsimit fillor dhe sistemi për trajnim plotësues të arsimtarëve; të shkëputet Ligji për Universitetin “Damjan Gruev” dhe të miratohet Ligj i ri për arsimin e lartë, i cili do ta forcojë autonominë dhe përgjegjësinë e Universitetit dhe do të vendoset model i ri i organizimit studentor. Rishikimi i ligjeve të tjera në arsim duhet të përfshijë demokratizimin në menaxhimin e shkollave dhe gjatë zgjedhjes së drejtorëve dhe mësuesve, pjesëmarrja dhe organizimi i shkollave të mesme, si dhe shlyerja e dispozitave të panevojshme ndëshkuese për mësuesit, nxënësit dhe prindërit. Përfaqësohemi me rishikimin e Strategjisë nacionale për plan veprimin për të rinj 2016-2025.

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|--|--|---|--------------|
| 1. | Miratimi i Strategjisë së re gjithëpërfshirëse për arsimin 2017-2027 | <ul style="list-style-type: none"> • Të sigurohet proces i gjërë konsultimi me të gjithë aktorët në rishikimin e (draft) Strategjies gjithëpërfshirëse për arsim 2017-2020 dhe harmonizimi i saj me prioritetet dhe masat nga dokumentet e tjera të politikave përkatëse strategjike në arsim *, si dhe me standardet e BE-së për arsim dhe trajnim 2020 dhe korniza e cilësisë evropiane si pika kryesore e referencës. • Të përpilohen të reja dhe të bëhen të qasshme të gjitha analizat ekzistuese për gjendjen e efekteve nga masa të ndryshme dhe/ose projekte të zbatuara dhe për çështje të tjera arsimore, që të shërbejnë si bazë për krijimin e politikave të bazuara në prova. • Duke pasur parasysh se për efekte pozitive në arsim nevojiten ndërhyrje afatgjate, në vend kornizës kohore tre-vjeçare propozojmë kornizë kohore dhjetë-vjeçare për Strategjinë (2017-2027); <i>* Strategjia për arsim të mesëm profesional; Konceptet për arsim fillor, për arsim joformal dhe për arsim ndërkulturor; Strategjia Nacionale dhe Plani i Veprimit për arsimimin e Romëve; Strategjia Nacionale për rrjetëzimin, bashkëpunim dhe zvogëlimin ikjes së stafit me arsim të lartë dhe profesional 2013 - 2020, etj.</i> | Ministria e arsimit dhe shkencës (MASH) | 6 |
| 2. | Reforma institucionale si parakusht për reformën arsimore | <ul style="list-style-type: none"> • Të rishqyrtohen mandatet, kapacitetet e disponueshme dhe rezultatet nga puna e institucioneve nacionale ekzistuese kompetente për mbikëqyrje, cilësi, krijim dhe zbatim të planeve dhe programeve arsimore: Byroja për Zhvillimin e Arsimit (BZHA), Inspektorati Shtetëror i arsimit (ISHA), Qendra Shtetërore për Provime (QShP), Qendra për arsim të mesëm profesional dhe trajnim (QAMPT), Qendra për Arsimin e të Rriturve, Enti për promovimin e arsimit në gjuhët e komuniteteve (EPAGjK) Bordi për akreditim dhe vlerësimin në AL (BOAVAL), Shërbimi pedagogjik, etj. për tu përmirësuar efikasiteti i punës së tyre dhe për të siguruar profesionalizmin e tyre (p.sh.. BZHA në vitet e fundit ngec me ndihmën profesionale adekuate e cila u është e domosdoshme arsimtarëve). | MASH | 12 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|---|--|---|--------------|
| 3. | Rritja e përfshirjes dhe përmirësimit të arsimit parashkollor | <ul style="list-style-type: none"> Të miratohet Ligji veçantë për arsimin parashkollor me të cilin do të rregullohet mësimi dhe zhvillimi i hershëm fëmijëror, parimet dhe praktika cilësore pedagogjike në arsimin parashkollor, statusin dhe trajnimin e kuadrit arsimor në institutet parashkollore etj. | MASH dhe Ministria për punë dhe politikë sociale (MPPS) | 12 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Të miratohet korniza evropiane për kualitet të zhvillimit të hershëm fëmijëror. | MASH dhe MPPS | 6 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Rishikimi i standardeve për zhvillimin e hershëm fëmijëror. | MASH dhe MPPS | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Të përpilohet dhe të zbatohet politika e përfshirjes falas të fëmijëve të grupeve të marginalizuara në arsimin parashkollor një vjet para shkuarjes në shkollë. | MASH dhe MPPS | 12 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Të fillojë procesi i përmirësimit të vazhdueshëm të rrjetit të institucioneve parashkollore (ndërtimin e të reja dhe/ose përmirësimin e institucioneve ekzistuese, veçanërisht në mjediset rurale dhe vendet ku nuk ekzistojnë, por që ka nevojë për ato. | MPPS, MASH dhe komunat | 12 |
| 4. | Avancimi dhe zbatim i sistemeve efikase për sigurimin e kualitetit në arsim | <ul style="list-style-type: none"> Vendosjen e sistemit nacionalë për kontrollimin e arritjeve të nxënësve në arsimin fillor në fund të ciklit të dytë dhe të tretë (VI dhe IX klasa) dhe njëherë në vitin e dytë të arsimit të mesëm (në shembull përfaqësues nxënës dhe shkolla), i cili duhet të sigurojë informacione kthyesë për arritjet e nxënësve dhe do të jetë në funksion vetëm për përmirësimin e kualitetit të arsimit dhe mësimin. Të vazhdohet pjesëmarrja në testimet ndërkombëtare (TIMSS, PIRLS, PISA) për shkak të krahasimit me trendët ndërkombëtare dhe krijimin e politikave efektive arsimore. | MASH, QShP, BZhA | 12 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Të vazhdohet me zbatimin e studimit nacional për alfabetizëm matematik dhe gjuhësor në 3 klasat e para (EGRA dhe EGMA) dhe të zhvillohen instrumente të ngjashme të standardizuara për klasat e tjera, me çka do të mundësohet përcjellja longitudinale e arritjeve të nxënësve, krahasimi i trendëve dhe ndërmarrja e masave për përmirësimin e gjendjes. | MASH, QShP, BZhA | 12 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|-----------|--|---|--|--------------|
| | | <ul style="list-style-type: none"> Të miratohet Ligj i ri për kontrolle të kualitetit në AL, të cilin do ta sigurojë Bordi për akreditim dhe vlerësim të jetë agjenci e pavarur dhe profesionale dhe si e tillë të jetë hapi i parë për anëtarësimin në Regjistrin Evropian për Kontrollim të Kualiteti ENQA dhe EQAR. Ligji i Ri për arsimin e lartë duhet të mundësojë vendosjen e sistemeve të brendshme për sigurimin e kualitetit të institucioneve të arsimit të lartë. | MASH, Bordi për akreditim dhe vlerësim të AL, universitetet | 3 |
| 5. | Reforma e programeve arsimore dhe përmirësimin e kualitetit të librave | <ul style="list-style-type: none"> Në bazë të analizave të përpiluara dhe gabimet e identifikuara dhe lëshimet, të fillojë procesi i rishikimit të programeve arsimore ekzistuese dhe librave. Reforma e tillë duhet të drejtojë kah rezultatet e mësimit të përcaktuara me standardet nacionale për çdo cikël arsimor, drejt harmonizimit me karakteristikat zhvilluese dhe me moshën e fëmijëve, harmonizim dhe integrimin e përmbajtjeve mes lëndëve të ndryshme dhe zbatim të integruar të të njëjtave, me çka do të zvogëlohej numri i lëndëve. Programet arsimore dhe librat duhet të promovojnë vlera demokratike, respektimin e të drejtave njerëzore, barazia gjinore, diversiteti, të nxisin integrim multietnik dhe të kultivojnë kulturë për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor (si pyetje horizontale). Rekomandojmë reformat e ardhshme arsimore (veçanërisht ato që nënkuptojnë intervenim në kurikulën) të futen me shumë kujdes, të njëjtat të jenë paraprakisht të testuar/pilotuara dhe të vlerësuara për efektet e rezultateve të tyre. Rritja dhe pjesëmarrja e detyrueshme e praktikuesve në krijimin e programeve dhe teksteve të reja. | MASH, BZhA, QShP, Shërbimi pedagogjik, publiku ekspert, organizatat qytetare, praktikantët | 12 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|---|---|--|--------------|
| 6. | Inkluzioni thelbësor i fëmijëve të cilët kanë nevojë të ndihmës shtesë në arsim | <ul style="list-style-type: none"> • Të miratohen modele të ndryshme për mbështetje shtesë të shkollave dhe klasave me fëmijë me nevoja të veçanta (me pengesa mentale apo fizike, me probleme socio-emo-cionale, bihaviorale dhe socio-ekonomike, barriera kulturore ose gjuhësore). • Identifikimi i të gjithë fëmijëve të cilët janë në moshë për shkollë, por nuk janë përfshirë në institucionet arsimore dhe përfshirja e tyre në sistemin arsimor përmes modelit për mbështetje specifike dhe individuale, tek e cila mund të përfshihen organizatat qytetare (sipas kriterëve të caktuara). • Për fëmijët që kthehen nga jashtë vendit, të cilët kthehen me klasë të pakryer, është e nevojshme të zhvillohen mënyra fleksibile për pranimin e periudhave të kaluara në arsimin, si dhe sistem/model për vlerësimin e njohurive dhe aftësive të tyre pas kthimit të tyre në vend, sipas standardeve të përkufizuara për klasat. të mundësohet vendosja e tyre në procesin arsimor me mbështetje shtesë nga ana e shkollave dhe/ose organizatat qytetare (sipas kriterëve të caktuara). • Arsimi iniciues i arsimtarëve të përfshijë përm-bajtje për punë me këtë nxënës në të gjitha programet dhe lëndët e tyre. • Të sigurohet trajnim shtesë dhe mbështetje e vazhdueshme për arsimtarët në shkollat fillore dhe të mesme për punën me këta fëmijë. • Në bashkëpunim me familjet dhe shkollat, të sigurohet ndihmës i fëmijës që ka nevojë nga kjo. | MASH, BZha, NJVL, fakultetet për arsimin e arsimtarëve nga universitete të ndryshme (shtetëror dhe privat), shkollat | 9 |
| 7. | Avancimi i arsimit dhe trajnimi i arsimtarëve | <ul style="list-style-type: none"> • Shfuqizimin e Ligjit për akademinë për arsimtarë. • Harmonizimin e arsimit iniciues të arsimtarëve me sistemin për arsimin fillor nëntëvjeçar. • Të vendoset model përkatës për arsimin e arsimtarëve nga fakultetet për arsimtarë, të cilët e zgjedhin profesionin e arsimtarit. • Të harmonizohet profili dhe kualifikimi i arsimtarit në arsimin fillor dhe të mesëm në të gjitha fakultetet e arsimit, në pajtim me standardet e kërkuara dhe kompetencat për arsimtarë. • Liberalizimi i trajnimeve të arsimtarëve dhe vendosja e modelit adekuat për akreditim të dhënësve të trajnimit. | MASH, BZha, fakultetet për arsimin e arsimtarëve nga universitete të ndryshme (shtetëror dhe privat) | 9 и 12 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|---|--|--|----------------|
| 8. | Përmirësimi i bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes së organizatave qytetare | <ul style="list-style-type: none"> Vendosja e mekanizmeve për bashkëpunim dhe konsultim të vazhdueshëm me organizatat qytetare dhe me palët e tjera të prekura (veçanërisht shoqatat e arsimitarëve, prindërit, studentët, nxënësit e shkollave të mesme, sindikatat, ato esnafe dhe shoqata të tjera profesionale) për: përpilimin e dokumenteve strategjike, mbledhja aktuale e informatave kthyesë për suksesin e tyre në praktikë, përfshirja e tyre në monitorim dhe vlerësimin e implementimit dhe dhënien e propozimeve për përmirësimin e reformave të parapara. MASH ti marrë para sysh analizat dhe hulumtimet e bëra nga organizatat qytetare. | MASH dhe organizatat qytetare | në kontinuitet |
| 9. | Përmirësimi i drejtimit dhe menaxhimi me institucionet arsimore | <ul style="list-style-type: none"> Të rishikohen ligjet për arsimin fillor dhe të mesëm që ka të bëjë me mënyrën e zgjedhjes dhe emërtimit të drejtorëve, si dhe mënyrën e zgjedhjes së prindërve dhe arsimitarëve në bordet shkollore, për tu përmirësuar kualiteti i kandidatëve të zgjedhur, të parandalohet ndikimi politik dhe ndikime të tjera, të zmadhohet transparenca, si dhe pjesëmarrja e tyre në vendimmarrje në shkollat. Ligji i ri për arsim të lartë duhet të sigurojë transparençë më të madhe dhe model të ri që do t'i demokratizojë proceset e zgjedhjes së dekanëve në institucionet e arsimit të lartë dhe rektorëve universitarë. | MASH dhe të gjitha palët e prekura | 12 |
| 10. | Përforcimi i autonomisë së Universitetit | <ul style="list-style-type: none"> Të përpilohet Ligji i ri për arsimin e lartë (AL) në konsultim me komunitetin më të gjerë akademik dhe studentët, që do ta forcojnë autonominë e Universitetit, do të sigurohet zhvillim cilësor dhe i qëndrueshëm i veprimtarisë arsimore të lartë, financim i qëndrueshëm i institucioneve arsimore të larta, pjesëmarrja thelbësore e studentëve në trupat për vendimmarrje në institucionet e arsimit të lartë dhe universitetet, pluralizëm dhe avancimi i modelit zgjedhor të organizmit studentor. Përfshirja e kuadrit akademik i punësuar në institucionet e larta arsimore nga Ligji për të punësuarit në sektorin publik, që do të mundësojë po politikë autonome të kuadrove të universiteteve dhe hulumtimeve shkencore të brezit të ri. | MASH dhe universitet në RM Bordi për akreditim dhe vlerësim të AL | 3 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|------------|---|---|--|--------------|
| | | <ul style="list-style-type: none"> Përjashtimi i institucioneve të larta arsimore nga sistemi i financimit nga thesari. | MASH, universitetet në RM dhe Këshilli për zhvillim dhe financim të arsimit të lartë | 9 |
| 11. | Konsolidimi me rrjetin ekzistues dhe parandalimi i ekspansionit të mëtejshëm të universiteteve shtetërore | <ul style="list-style-type: none"> Të shfuqizohet Ligji për Universitetin "Damjan Gruev", që të vihet në pyetje cilësia dhe kredibiliteti i profesioneve të rregulluara me këtë Ligj. Të rishqyrtohet cilësia dhe realizueshmëria shoqërore e studimeve të shpërndara në fakultetet e tjera shtetërore në Shtip (UGD), Manastir (UKLO) dhe në Tetovë (USHT) | MASH | 3 |
| 12. | Rritja e mbështetjes dhe avancimi i veprimtarisë shkencore-hulumtuese | <ul style="list-style-type: none"> Të përpilohet Ligji ri për veprimtarinë shkencore-hulumtuese, e cila do ta avancojë statutin e shkencës dhe hulumtimit. Formimi i Agjencisë si trup i pavarur që do të jetë kompetente për realizimin transparent dhe efektiv të Programit nacional për veprimtari shkencore-hulumtuese dhe për bashkëpunim ndërkombëtar. Mbështetje buxhetore për financimin e programeve hulumtuese dhe projekteve (nacionale, bilaterale, të interesit nacional), infrastruktura hulumtuese, mbështetje për hulumtuesit e rinj dhe pjesëmarrje e rritur në projektet hulumtuese ndërkombëtare. | MASH, universitetet dhe institutet hulumtuese | 12 |
| 13. | Avancimi i organizimit shkollor të mesëm, pjesëmarrja dhe standardi studentor | <ul style="list-style-type: none"> Sigurimi i kushteve ligjore dhe funksionimi praktik i organizimit shkollor të mesëm (përmes amendamenteve adekuate) në Ligjin për arsim të mesëm, në bashkëpunim me përfaqësuesit e Plenumit shkollor të mesëm dhe organizatave qytetare për të rinj. Përkufizim më preciz i standardit të nxënësit dhe studentit dhe zgjerimi i tyre në Ligjin për arsim të mesëm, Ligji për arsim të lartë, Strategjia për të rinjtë. | MASH, ARS | 3 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|---|---|---|--------------|
| 14. | Trupa përfaqësues për të rinjtë | <ul style="list-style-type: none"> • Njohja e KNRM si trupi më i madh përfaqësues për të rinjtë nga ana e institucioneve. • Përcaktimi i mekanizmave për bashkëpunim të KNRM me institucionet në sferën e politikave rinore dhe pjesëmarrjes. • Formimi i trupit udhëheqës për bashkëpunim me KNRM dhe ARS. • Anulimi i zgjedhjes për përfaqësues rinor të Maqedonisë në ZRRBP. • Krijimi i sistemit legjitim transparent për zgjedhje të përfaqësuesi në ZRRBP. • Zbatimi i zgjedhjeve të reja për përfaqësues rinor, të organizuara nga KNRM dhe ARS. • Krijimi i modelit të standardizuar për krijimin e këshillave lokale rinore, të njohura nga njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe nga Qyteti Shkup. | Agjencia për të rinj dhe sport, MPPS, MASH, MF, Ministria e vetëqeverisjes lokale, NjVL, Agjencia për punësim në Republikën e Maqedonisë, Ministria për ambient jetësor | 3 |
| 15. | Përmirësimi i Strategjisë për të rinjtë | <ul style="list-style-type: none"> • Organizmi i procesit konsultativ për revizion të Strategjisë për të rinjtë. • Krijimi i plan veprimeve 2018-2019 në proces të hapur. • Ndarja e mjeteve buxhetore për realizimin e plan veprimeve. | ARS, MF | 3 |
| 16. | Reforma e Agjencisë për të rinj dhe sport | <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi i Agjencisë për të rinj dhe sport, revizioni i punës me projekte, financiare, të personelit, me fokus të veçantë në sektorin për të Rinj. • Krijimi i ndryshimeve thelbësore për përmirësimin e ARS në sektorin <i>Të rinjtë</i> dhe ndarja e buxhetit adekuat përmes një procesi të gjerë konsultues. • Formimi i trupit ko-udhëheqës mes ARS dhe KNRM. | ARS, Enti shtetëror për revizion, Qeveria e Republikës së Maqedonisë | 9 |
| 17. | Punësimi i të rinjve | <ul style="list-style-type: none"> • Njohja e profesionit punëtor i ri • Standardizimi i kualifikimeve dhe shkathtësive të punëtorit rinor. • Programi për trajnim të punëtorëve të rinj. • Ndarja e mjeteve për punë rinore. • Krijimi i qendrave lokale rinore. • Vlerësimi i masave ekzistuese për punë rinore. • Ndarja e buxhetit për punë rinore. | ARS, Agjencia për punësim në Republikën e Maqedonisë, MPPS, Ministria e ekonomisë, Qendra për trajnim dhe arsim për të rritur. | 9 |

MJEDISI JETËSOR

Duke marrë para sysh shumëllojshmërinë dhe diversitetin e problemeve në sferën e mjedisit jetësor dhe duke i dhënë prioritet të ulët këtyre çështjeve në periudhën e kaluar, e drejta kushtetuese për një mjedis jetësor të pastër për qytetarët e Republikës së Maqedonisë është e cenuar në masë të konsiderueshme.

Në këtë dokument janë listuar masat më urgjente dhe më të nevojshme që duhet të ndërmerren në disa fusha që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor, në mënyrë që të fillohet me zgjidhjen e problemeve me të cilat ballafaqohet sektori. Masat janë të lidhur me problemet më të ngutshme, si janë: Ndotja e ajrit, monitorimi në ambientin jetësor dhe financimi i sektorit, por edhe me deponime, ndotja historike, ndryshimet klimaterike, mbrojtja e natyrës, ujit, kanalizimit dhe pjesëmarrja në publik. Është e rëndësishme kyçe të braktiset praktika e deritanishme e përcaktimeve deklaruese për zgjedhjen e problemeve dhe të fillohet me zbatimin praktik të masave të përshkruara në këtë dokument.

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|----------------|---|---|--------------|
| 1. | Ndotja e ajrit | <ul style="list-style-type: none"> Formimi i grupit punues për gjetjen e modusit për karakterizimin e automjeteve në varësi prej emetimeve të matura për kohë të kontrollit teknik. Grupi punues duhet të bëjë analizë të ligdhënasi dhe të mundësive për zgjedhjen e pjesëmarrjeve të kategorive të ndryshme të automjeteve, në pajtim me këtë kategorizim, në komunikacion në periudha të ndotjes së ajrit. Grupi punues duhet të jetë i përbërë nga përfaqësues të të gjitha institucioneve kompetente dhe të gjejë mënyrë që kategoria e propozuar të përfshihet në të gjitha aktet ligjore relevante. | Ministria e ambientit jetësor dhe planifikim hapësinor (MAJPH), Ministria e punëve të brendshme (MPB), Ministria për transport dhe lidhje (MTL) | 6 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Mundësimi i rregullt i funksionimit adekuat dhe transparent të Komitetit për shëndetësi dhe ambient jetësor. | Qeveria e RM | 3 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|--------------------------------|---|---|-------------------------------------|
| 2. | Mbrojtja e natyrës | <ul style="list-style-type: none"> Miratimi urgjent i Strategjisë për biodiversitet dhe sjellja e mbrojtjes kohore për pjesët kryesore të rrezikuara, me vendim të Ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. për rajonet e mbrojtura të ardhshme Mali Sharr dhe Jablanica. | Qeveria e RM, MAJPH, Komunitat kompetente | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Miratimi i Ligji të ri për natyrën. | MAJPH, Qeveria e RM, Kuvendi | 9 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Vënia në funksion e Sistemit nacional informativ për biodiversitet, përmes mundësimin të kushteve teknike për funksionimin e saj adekuat të akteve nënligjore për zgjerim të të drejtave dhe detyrimeve në lidhje me të dhënat për biodiversitetin. | MAJPH, Qeveria e RM | 9 |
| 3. | Industria | <ul style="list-style-type: none"> Përpilimi i notës strategjike për planet e përgjithshme për xeherore në Maqedoninë lindore dhe aftësimi adekuat për planet në varësi nga rezultatet e notës strategjike. | Zv. Kryeministri për çështje ekonomike, MAJPH, Ministria e ekonomisë (ME) | 3 (fillimi me masën), 12 (mba-rimi) |
| 4. | Ndotja historike | <ul style="list-style-type: none"> Fillimi me shqyrtimin me 16 "pikat e nxehta" të ndotjes historike duke filluar me dislokimin e lindanit nga rrethi i fabrikës Ohis i cili tashmë është projekt i hartuar dhe janë siguruar një pjesë e fondeve | MAJPH, komuna përkatëse | 3 |
| 5. | Ndryshimet klimaterike | <ul style="list-style-type: none"> Ratifikimi urgjent i Marrëveshjes së Parisit. | Kuvendi, MAJPH | 3 |
| 6. | Monitorim në ambientin jetësor | <ul style="list-style-type: none"> Përforcimi i kapaciteteve për monitorim të ambientit jetësor dhe vendosja e nderimit të tretë në shërbimet e inspektiveve. Publikimi i gjetjeve të inspektiveve të kryera në faqen e internetit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit. | MAJPH, Inspektorati shtetëror i mjedisit, komunat | 6 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|--|--|--|--------------|
| 7. | Mbetje | <ul style="list-style-type: none"> Transpozimi i plotë i Kornizës së Direktivës të BE-së për mbeturina dhe fillimi i implementimit të aktiviteteve për trajtimin e mbeturinave në përputhje me këtë Direktivë. Të mundësohet sistematizimi i punës së mbledhësve joformal të mbeturinave dhe përfshirja e tyre më e madhe menaxhimin me mbetjet dhe të stimulohet seleksionimi i mbeturinave në familje. Seleksionimi i detyrueshëm e mbeturinave në institucionet dhe aftësimi i prokurimit publik në mënyrë që të zvogëlohet sasia e mbeturinave. | MAJPH, sipërmarrjet publike komunale, komunitat | 12 |
| 8. | Qasja në ujë dhe kanalizime për të gjithë qytetarët nuk është e mundur | <ul style="list-style-type: none"> Formimi i Komisionit Rregullator për ujëra. | Qeveria e RM, Kuvendi, MAJPH, Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe e ujërave (MBPU), ME, Ministria e Financave (MF) | 12 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Ratifikimi i Protokollit për ujëra dhe kanalizime dhe fillimi me zbatimin e detyrimeve të të njëjtave. | Qeveria e RM, MAJPH, Kuvendi, MBPU, Ministria e shëndetësisë (MSh), komunitat | 6 |
| 9. | Revidimi i sektorit të pylltarisë | <ul style="list-style-type: none"> Zbatimi i transformimit të filluar të SP Pyjet e Maqedonisë dhe revidimi i Strategjisë dhe Ligjit për pyje në pajtim me praktikatat evropiane dhe botërore dhe me pjesëmarrje të gjerë të publikut dhe të gjitha palëve të prekura. | Qeveria e RM, MAJPH, SP Pyjet e Maqedonisë | 12 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Përpilimi i miratimit të metodologjisë dhe afateve për inventarizim të pyjeve në Republikën e Maqedonisë. | MAJPH, SP Pyjet e Maqedonisë | 6 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Miratimi i Ligji të ri për kullostat. | MPU, Fond për kullostat, SP Pyjet e Maqedonisë, SP për kullostat | 9 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|---|---|---|--------------|
| 10. | Turizmi i cili stimulohet në Republikën e Maqedonisë është i pa qëndrueshëm dhe nuk e vlerëson si duhet burimin e saj kryesor - mjedisin | <ul style="list-style-type: none"> Angazhimi për tu ridrejtuar kah turizmi i qëndrueshëm dhe mundësimi i subvencioneve për turizëm të qëndrueshëm, si masë për mbështetje në realizimin e këtij angazhimi. | Qeveria e RM, ME, Agjencia për promovimin dhe mbështetjen e turizmit | 12 |
| 11. | Pjesëmarrja e publikut është në nivel joadekuat që të mundëso kontribut cilësor në kohë të gjitha palëve të tanguara në proceset në lidhje me ambientin jetësor | <ul style="list-style-type: none"> Zbatimi i Konventës së Arhusit dhe përpilimi i të gjitha dokumenteve strategjike me pjesëmarrje të gjerë në publik. Shfrytëzimi i portalit ekologjik Ekosfera.mk nga ana e institucioneve kompetente për të publikuar informata të rëndësishme për sektorin e mjedisit. | Qeveria e RM, të gjitha ministratë me theks në MAJPH, ME, MSh, MBPU, MTL, komunitat | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Hapja e bazave të të dhënave në lidhje me mjedisin jetësor dhe sigurimin se do të jenë të qasshme përmes internetit. | Të gjitha institucionet të cilat kanë ndonjë kompetencë në lidhje me mjedisin jetësor | 6 |
| 12. | Financim në mjedisin jetësor | <ul style="list-style-type: none"> Rekrutimi në MAJPH me qëllim që të ndahen shërbimet e pavarura të cilat duhet t'i sigurojë në lidhje me mbrojtjen e mjedisit përmes ngritjes së statusit të Drejtorisë për mjedis jetësor në Agjencinë për ambient jetësor, e cila do të ndërmer kompetencat nga sfera e VNAJ (Vlerësimi në ndikimin mbi ambientin jetësor), NSAJ (Nota strategjike e ambientit jetësor), Direktiva për emetime industriale, dhënia e lejeve ekologjike, etj. | Qeveria e RM, Kuvendi, MAJPH, Drejtoria për ambient jetësor | 12 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Formimi i fondit për mjedisin jetësor dhe ri drejtim të tatimeve dhe taksave të lidhura me ambientin jetësor në këtë fond. | Qeveria e RM, MF, MAJPH, Kuvendi | 12 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Rritja e buxhetit për mjedisin jetësor. | Qeveria e RM, MF, MAJPH, Kuvendi | 6 |

ENERGJETIKA

Është e domosdoshme të rishikohet sektori energjetik në Republikën e Maqedonisë, para së gjithash për shkak të varësisë nga thëngjilli (lignit) i cili është i qasshëm nga burime vendore vetëm për periudhë relativisht të shkurtër. Përveç kësaj, burimet e reja të energjisë rinovuese nuk janë të shfrytëzuara mjaftueshëm dhe Republika e Maqedonisë ende nuk është integruar si duhet në rrjedhat rajonale dhe evropiane.

Në këtë dokument janë gjendur masat më urgjente që duhet të ndërmerren në mënyrë që sektori të drejtohet me hapa të shpejta kah ekonomia me thëngjill të ulët dhe transparencë dhe përfshirje më të mirë. Mes tjerash, dokumenti, e thekson nevojën për miratimin e vendimeve në lidhje me sektorin energjetik me pjesëmarrje të gjerë në publik.

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|--|---|---|--------------|
| 1. | Planifikim në sektorin energjetik | <ul style="list-style-type: none"> Verifikim i moratoriumit të paraqitur për vendosjen e energjisë bërthamore. | Qeveria e RM (QRM), Kabineti i zv. Kryeministrit për çështje ekonomike | 3 |
| 2. | Zbatimi i standardeve për mjedisin jetësor për kapacitetet energjetikës | <ul style="list-style-type: none"> Shpallje tenderi për furnizim të sistemit për desulfurizim të REK Manastir. | Planifikimi i (MAJPH) | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Fillimi me trajtimin adekuat të hirit nga REK Manastir. | QRM, ELEM, MAJPH | 3 |
| 3. | Pjesëmarrja e publikut në miratimin e planeve dhe vendimeve në fushën e energjetikës | <ul style="list-style-type: none"> Sigurimi i konsultimeve të gjera publike për të gjitha planet, vendimet dhe ligjet nga sfera e energjetikës, përfshirë edhe Strategjinë për energjetikë dhe Ligjin për energjetikë. | QRM, Kabineti i zv. Kryeministrit për çështje ekonomike, Kuvendi, Ministria e Ekonomisë (ME), MAJPH, ASHAM, ELEM, MEP-SO, Agjencia për energjetikë (AE), Komisioni rregullator për energjetikë (KRrE) | 3 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|-----------|---------------|---|---|--------------|
| | | <ul style="list-style-type: none"> Sigurim se asnjë nga të gjitha projektet infrastrukturore të planifikuara nuk janë në konflikt me qëllimet dhe prioritetet për mbrojtjen e natyrës dhe nuk janë në rajonet e mbrojtura. | QRM, Zv. Kryeministri për çështje ekonomike, ME, MAJPH, | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Vendosja e instrumentit për informimin në lidhje me energjetikën, që të arrihet transparencë dhe qasje e informatave. | Zv. Kryeministri për çështje ekonomike, ME, AE, KRE | 9 |
| 4. | Legjislacioni | <ul style="list-style-type: none"> Transpozim komplet dhe adekuat e të drejtës së BE nga sfera e energjetikës në legjislacionin në RM dhe përmirësimi i Ligjit për energjetikë dhe të akteve nënligjore, në mënyrë që do të mundësojë rregullim më të mirë të përdorimit të burimeve të reja rinovuese, subvencioneve në energjetikë, decentralizimi i prodhimit të energjisë, përkufizimi dhe përballja me varfërinë energjetike, si dhe përpilim dhe miratim i dokumenteve strategjike nga sfera e energjetikës. | QRM Zv. Kryeministri për çështje ekonomike, ME, AE, KRE | 6 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Përkufizimi i shpenzuesve të cënuar si bazë për krijimin e masave për përballje me varfërinë energjetike dhe ndryshimi i metodës për ballafaqim me problemin. | ME, MPPS, Ministria e Financave (MF) | 6 |
| 5. | Liberalizimi | <ul style="list-style-type: none"> Fillimi me procesin e liberalizimit të tregut në energjinë elektrike dhe integrimin e RM në tregun energjetik rajonal. | QRM zv. Kryeministri për çështje ekonomike, ME, AE, KRE, MF, MEPSO, ELEM, EVN | 6 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|-----------------------------------|--|---|--|
| 6. | Planifikim në sektorin energjetik | <ul style="list-style-type: none"> Përkufizimi i përcaktimit strategjik të shtetit në lidhje me synimet e RM në sektorin energjetikë deri në 2030 dhe 2050. Gjatë përkufizimit të përcaktimit strategjik është i domosdoshëm prioriteti më i lartë të jetë dekarbonizimi i sektorit energjetik dhe të sektorëve të tjerë relevant (transporti, industria, bujqësia), që do të reflektohet edhe në ndryshimin në kohë të dokumenteve strategjike në këta sektorë. Motivim të shfrytëzohet ngrohja qendrore kudo ku është e pranishme, me qëllim që të zvogëlohet ndotja e ajrit dhe stimulimi për shfrytëzim të metodave alternative për nxehe të cilat nuk përfshijnë përdorimin e karburanteve të ngurtë. Revizioni i Propozim-strategjisë për energjetikë, në pajtim me dispozitën e re strategjike për dekarbonizim. Fillimi me përmirësimin e rrjetit përcjellës me qëllim përfundimtar të ndërtohet rrjet përçues elektrik për lidhje cilësore në sistemin evropian energjetik. Vendosja e angazhimit për dekarbonizimin dhe kursimin e energjisë (braktisja e lëndëve djegëse fosile) në të gjitha nivelet e procesit arsimor. Miratimi i angazhimit për elektrifikim të tërësishëm të transportit deri në vitin 2050. | <p>QRM, Kabineti i zv. Kryeministrit për çështje ekonomike, ME, Ministria e transportit dhe lidhjeve (MTL), MBPE, Oda ekonomike e RM</p> <p>QRM, Zv. Kryeministri për çështje ekonomike, KRE, ME, MAJPH, shpërndarësit e rrjeteve me ujë të ngrohët</p> <p>QRM, Kabineti i Zv. Kryeministrit për çështje ekonomike, Kuvendi i RM, ME, MAJPH, MANU, ELEM, MEPSO, KRE, AE</p> <p>QRM Kabineti i Zv. Kryeministrit për çështje ekonomike, ME, MEPSO</p> <p>QRM, Ministria e arsimit dhe shkencës, Byro për zhvillim të arsimit</p> <p>QRM Zv. Kryeministri për çështje ekonomike, ME, MTL, ASHAM</p> | <p>6</p> <p>6</p> <p>9</p> <p>12</p> <p>12</p> <p>12</p> |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|---|--|--|-------------------------|
| 7. | Institucionet | <ul style="list-style-type: none"> Përmirësimi i kapaciteteve të resurseve njerëzore në institucionet me kompetenca në sferën e energjetikës. | ME, Agjencia për energjetikë, Komisioni rregullator për energjetikë, MAJPH | 12 |
| 8. | Hulumtime dhe analiza | <ul style="list-style-type: none"> Fillimi i procesit të hartimit të kartës hidrologjike dhe diellore, rinovimi i kartës të erës dhe përputhja e tyre me planin hapësinor në Republikën e Maqedonisë. Përpilimi i analizave për burimet e mbeturinave nga bujqësia, blegtoria, në mënyrë që të hartohen lokalet më të mira për përpunimin e centraleve në biokarburant (biogas) | Zv. Kryeministri për çështje ekonomike, instituti nga sferat relevante, komuna, Agjencia për planifikim hapësinor. | 12 |
| 9. | Krahasimi i standardeve për ambientin jetësor për kapacitetet energjetike | <ul style="list-style-type: none"> Harmonizimi i kapaciteteve energjetike me planet operative dhe teknikat më të mira të pranishme, në pajtim me të drejtën e BE-së. | QRM, MAJPH, Operatorë të kapaciteteve energjetike, Komunat | 12 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Instalimi i sistemeve për desulfurizim të REK <i>Manastir</i>. | QRM, ELEM. MAJPH | 12 |
| 10. | Stimulimi i efikasitetit energjetik dhe shfrytëzimi i burimeve rinovuese të energjisë (BRE) | <ul style="list-style-type: none"> Stimulimi i prodhimit të energjisë në amvisëritë përmes mundësisë së subvencioneve për prodhuesit të energjisë elektrike nga dielli dhe era. | QRM Zv. Kryeministri për çështje ekonomike, ME, MF, AE, KRE | 12 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Formimi i fondit për efikasitet energjetik i dedikuar për qytetarët dhe për objektet publike (çerdhe, shkolla, spitale, objekte komunale) dhe miratimi i politikave për stimulimin e efikasitetit energjetik. | QRM Zv. Kryeministri për çështje ekonomike, ME, MF, AE, KRE, komunat, bankat komerciale | 12 (fillimi i procesit) |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Rritje e ndjeshme e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e reja rinovuese energjetike, në mënyrë që të mundësohet tranzicioni i përshpejtuar i dekarbonizimit të sektorit. | QRM Zv. Kryeministri për çështje ekonomike, ME, AE, KRE | 12 |

KULTURË

„Arti Dhe kultura janë me rëndësi esenciale, vetëm nëse dikush e di për se.“

Zhan Kokto

Ndërtimi i ndërtesave, përmendoreve, institucioneve të reja të qëndrueshme kulturore, (shumica si pjesë e projektit kontrovers “Shkupi 2014”), mos investimi në qasje inovative dhe bashkëkohore dinamike në kulturë, administrata e zmadhuar, mbështetja e zvogëluar e formave të reja të shprehjes dhe të industrive kreative, promovimi dhe nxitja e narracionit etno - nacionalist në kulturë dhe në produksionin artistik, si dhe ksenofobia, jo barazia dhe korrupsioni, janë karakteristikat kryesore të diskursit publik kulturor dhe politikave kulturore eksplicite dhe implicite gjatë viteve të kaluara.

Leksionin të cilin e mësuam të gjithë, nga qeverisja e regjimit gjatë periudhës prej vitit 2006 - 2017, është se kultura është vegël e fuqishme me të cilën mund të intervenohet madje edhe në ndryshimin e identitetit dhe fakteve historike të një shteti, për periudhë të shkurtë kohore (përsëri “Shkupi 2014” dhe të gjitha aktivitetet shoqëruese).

Njëkohësisht, Evropa jep impuls të fuqishëm dhe të rëndësishëm në identifikimin dhe rëndësinë e këtij segmenti, kështu që Mogerini deklaroi “ta vendosim kulturën në qendrën e politikës së jashtme evropiane”. Njëkohësisht, ajo thekson se “kultura është diçka shumë më e madhe dhe më e thellë nga agjenda e përditshme me krizat në politikën e jashtme të Evropës”.

Në konstalacion të këtyre të rrënimin të plotë të brendshëm të sektorit të kulturës dhe të parimeve themelore, mbi të cilat bazohet edhe kjo platformë, ndërsa nga ana tjetër, duke pasur parasysh perspektivën evropiane dhe impulsin e ri që vijin pikërisht në lidhje me kulturën, sektorin e pavarur të kulturës në RM, propozon shtatë prioritete me masa konkrete për implementim, në lidhje me intervenimin e shpejtë për veprimin e sektorit në dinamikën e re kulturore, si dhe në lidhje me saminin e një pjese të dëmeve të shkaktuara gjatë periudhës së kalua.

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|---|---|---|--------------|
| 1. | Rishikimi i institucioneve publike aktuale dhe propozimi i modeleve të reja | <ul style="list-style-type: none"> Kontabilitet forenzik dhe revizion i institucioneve me ndihmën e angazhimit të shtëpisë së pavarur revizore. | Qeveria e RM-së, Ministria e Kulturës (MK) | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Të formohet komision në të cilin do të përfshihen përfaqësues të Ministrisë së Kulturës, ekspertë dhe përfaqësues të sektorit të pavarur kulturor. Rishikimi i kriterëve dhe sistemeve për angazhimin e resurseve njerëzore në institucionet publike. Krijimi i kriterëve të reja për punësim, gjatë çka do të mbahet llogari për këto aspekte: Fjalën e urrejtjes, diskriminimin dhe dhunën. | MK | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Të formohet grup pune, në të cilin do të përfshihen edhe ekspertë dhe përfaqësues të sektorit të pavarur kulturor, që të përpilohet analizë fillestare për resurset ekzistuese të institucioneve publike. | MK | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Formimi qendrës për hulumtime sociale - kulturore dhe krijimin e politikave | MK | 12 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Moratorium të institucioneve të cilat bëjnë propagandë me narracion nacionalist dhe narracion të kurdisur historik, si dhe rishikimin e programit të tyre (për shembull: Prezantimet në Muzeun e VMRO-së, Muzeun Nacional të LNÇ-së në Kërçovë). | MK | 9 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Propozime për modele të reja të institucioneve (të hapura). | Qendra për hulumtime socio - kulturore dhe krijimin e politikave, skenë e pavarur | 9 - 12 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e) | Afati (muaj) |
|-----------|---|--|--|--------------|
| 2. | Sistematizim i ri në Ministrinë e Kulturës (vendosja e praktikave moderne kulturore) | <ul style="list-style-type: none"> Vendosja e sektorit të ri dhe linjës së re buxhetore e cila do të merret me praktikat moderne kulturore - inter-disiplinore. | MK | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Sigurimi i kushteve për mbështetje afatgjatë të projekteve dhe institucioneve (mbështetje vjetore dhe shumë vjeçare) dhe krijimi i fondit për ad - hok projekte. | MK | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Vendosja e fondit të veçantë për mobilitet (pjesëmarrja në festivale, pjesëmarrje në projekte ndërkom-bëtare, aksione urgjente). | MK | 12 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Rishikimi dhe mbi ndërtimi i sektorëve aktual (sipas veprimtarive) dhe propozimi i sektorëve të rinj. | Grupe pune të përbëra nga anëtarë të MK, ekspertë dhe sektori i pavarur kulturor | 12 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Strategjia për kulturë 2018 - 2022 (përfshirja e sektorit të pavarur kulturor, ekspertë, përkufizimi i kriterëve të qarta gjatë zgjedhjes së komisioneve dhe përgjegjësi gjatë përpilimi të saj). | MK | 3 |
| 3. | Transparencë dhe llogaridhënie (përkufizimi i kriterëve të qarta për punësim, thirrje për grante, programe) | <ul style="list-style-type: none"> Analizë e punës paraprake të Ministrisë së Kulturës në lidhje me shpërndarjen e financave (revizion forenzik). | Shtëpi e pavarur revizore | 12 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|-----------|---|---|--|--------------|
| | | <ul style="list-style-type: none"> Publikimi (në ueb faqen e Ministrisë së Kulturës) i të gjitha raporteve për punën nëpër sektorë gjatë 5 viteve të kaluara, si vijon: Programe, vendime, komisione, shuma të granteve dhe raporte. | MK | 12 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Zhvillimi i modelit të ri për komunikim për informata me interes publik. | MK | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Të rishikohen dhe të korrigojnë kriteret aktuale për të gjithë sektorët në veçanti: Thirrja për ndarjen e granteve, formularë / aplikime, përkufizimi i kriterëve për formimin e komisioneve, dhe kjo të bëhet publike. | MK, ekspertë dhe sektori i pavarur kulturor | 3 |
| 4. | Legjislati (rishikim dhe propozime për ndryshime të ligjeve) | <ul style="list-style-type: none"> Rishikim dhe analizë e Ligjit për kulturë dhe rekomandime - bashkëpunim ndërmjet Ministrisë, sektorit qytetar, Sindikatës për kulturë dhe Kuvendit. | MK, të gjitha grupet | 9 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Rishikimi i pjesës së Ligjit për kulturë, në lidhje me kompetencat dhe fuqinë për vendimmarrje të ministrit të Kulturës. | MK, ekspertë, sektori i pavarur kulturor | 12 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Rishikimi i marrëveshjeve kolektive dhe nivelizim. | MK, sektori qytetar, sindikatat, sektori i pavarur kulturor, grupe formale dhe joformale, individë | 12 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Përkufizimi i statusit të artistëve të pavarur dhe punëtorëve të kulturës. | MK, sektori qytetar, sindikata, sektori i pavarur kulturor, grupe formale dhe jo formale, individë | 9 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Përkufizimi i përqindjes së pjesëmarrjes nacionale në bashkëfinancimin e projekteve evropiane | MK | 3 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e) | Afati (muaj) |
|----------|--|---|---|--------------|
| 5. | Lëvizja nga multi-kulturalizmi drejt pluralizmit kulturor | <ul style="list-style-type: none"> Vlerësim i tendencave të deritanishme të programeve të institucioneve dhe të përfshirjes së parimit të pluralizmit në bazë të analizës për atë se cilat programe janë zbatuar gjatë 3 viteve të kaluara. | MK | 12 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Memorandum për subvencionimin e përmbytjeve të cilat mbështesin etno-nacionalizëm, ksenofobi dhe diskriminim. | MK dhe Fondi filmik | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Stimulimi i programeve të cilat do të promovojnë llojllojshmëri, tolerancë, përfshirje, participim dhe mundësi të barabarta, nëpërmjet vendosjes së kriterëve të reja në thirrjen për ndarjen e granteve të cilat do ti përfshijnë këto elemente. | MK | 9 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Analizë dhe vlerësim i gjendjes në të gjitha shkallët e arsimit e cila është në relacion me kulturën. | MK, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) | 12 |
| 6. | Lidhja ndër sektoriale (edukim, sociale, turizëm, ekonomi) | <ul style="list-style-type: none"> Vendosja e bashkëpunimit institucional me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës për krijimin e programeve të reja arsimore dhe mjeteve ndihmëse për afrimin e praktikave bashkëkohore kulturore dhe zhvillimin e mendimit kritik. | MK, MASH | 12 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Revizion i programeve dhe propozim për kurikula të reja për disiplina kulturore dhe praktika artistike. | MK, MASH | 12 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Mbështetje dhe zhvillim i programeve arsimore alternative të cilat do të stilumojnë kulturën kritike dhe do të sigurojnë shkathtësi transversale dhe teknike në sektorin e kulturës. | MK, MASH, sektori qytetar | 12 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e) | Afati (muaj) |
|-----------|--------------------------|--|---|------------------|
| | | <ul style="list-style-type: none"> • Revizion forenzik dhe revizion i ekspertëve për "Shkupi 2014". | Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit hapësinor, MASH, Ministria e Financave, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve dhe Vetëqeverisja Lokale | 3, 9, 12, |
| | | <ul style="list-style-type: none"> • Përcaktimi dhe analiza e resurseve që ekzistojnë në nivel lokal. | MK, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale | 12 |
| 7. | Decentralizim i kulturës | <ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i grupit të punës e cila do të propozojë modele të reja të qëndrueshme për hapësirat kulturore në territorin e Republikës së Maqedonisë. | MK, sektori qytetar dhe vetëqeverisja lokale | 12 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i masave stimulative për mbështetje të potencialit kreativ (talente) në nivel lokal. | MK, Vetëqeverisja lokale | 12 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i programeve rezidenciale për këmbimin e artistëve dhe operatorëve kulturor në territorin e Republikës së Maqedonisë. | MK, Vetëqeverisja lokale | 12 |

SHËNDETËSI

Gjendjet në lidhje me të drejtat shëndetësore të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, dhe në veçanti të drejtat shëndetësore të qytetarëve që bëjnë pjesë në grupet e rrezikuara, sugjeron në një sërë dobësi sistemore dhe pengesa për realizimin e të drejtës për shëndet, si e drejtë themelore njerëzore. Konfirmim për këtë janë analizat dhe raportet të cilat vite me radhë i përpilojnë organizatat qytetare dhe në bazë të tyre angazhohen për avancimin e shkallës së zbatimit të këtyre të drejtave. Rekomandimet dhe konkluzionet e trupave të ndryshëm ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, gjithashtu, e konfirmojnë dhe sugjerojnë, në lidhje me nevojën për ndërmarrjen e masave urgjente të cilat do të avancojnë shëndetin e qytetarëve, dhe në veçanti të ndërmerren masa përkatëse dhe specifike për eliminimin e barrierave me të cilat përballen qytetarët e grupeve të rrezikuara. Për këtë qëllim propozojnë ndërmarrjen e reformave sistemore dhe të vazhdueshme në fusha të ndryshme, të cilat do të thonë krijimin e parakushteve themelore dhe supozimeve për sistem shëndetësor i cili është i qasshëm, i arritshëm, i pranueshëm dhe ofron shërbime shëndetësore cilësore për qytetarët. Të këtilla janë reformat të cilat i propozojnë në fushën e avancimit të qasjes drejt barnave, përfshirjen e organizatave qytetare si ofrues të shërbimeve shëndetësore, mundësimin e sigurimit shëndetësor për të gjithë, sigurimin e kuadrit përkatës dhe profesional për sigurimin e mbrojtjes shëndetësore, dhe avancimin e diagnostikës. Nga ana tjetër, propozojmë ndërhyrje reformuese, të cilat kanë për qëllim të krijohet bazë solide dhe bazë për planifikimin dhe zbatimin e politikave shëndetësore reale, politika të cilat ju përgjigjen nevojave të qytetarëve, dhe në veçanti, grupeve të rrezikuara të qytetarëve. Të këtilla janë masat e propozuara për miratimin dhe buxhetimin e politikave të nevojshme shëndetësore, planifikimi përkatës dhe buxhetimi i programeve të Ministrisë së Shëndetësisë, dhe avancimi i mënyrës së udhëheqjes dhe shfrytëzimit të statistikës shëndetësore. Në propozimin e masave, shkuam edhe një hap më përpara, në drejtim të propozimit të vlerësimit për gjendjen në lidhje me indikatorët për vdekshmërinë e foshnjës së sapolindur, foshnjës që pi gji dhe vdekshmërinë perinatale. Kjo në veçanti, sepse ky indikator shëndetësor sugjeron për një trend jashtëzakonisht negativ, kështu që përcaktimi i shkaqeve për gjendjet e këtilla duhet të jetë prioriteti më i lartë. Me rëndësi të njëjtë janë edhe reformat që i propozojmë në lidhje me avancimin e mekanizmave për mbrojtjen për zbatimin e të drejtave shëndetësore, të cilat janë garanci për angazhimin faktik, dhe jo vetëm për angazhimin deklarativ për këto të drejta. Pa funksionimin e tyre është e pamundur të imagjinohet funksionimi i sistemit shëndetësor në përgjithësi.

Përpos reformave sistemore prioritare, propozojmë edhe një sërë ndërhyrje reformuese në lidhje me shëndetin e grupeve të caktuara të rrezikuara, siç janë: gratë, romët, personat që jetojnë me HIV/ AIDS, personat përdorues të drogave, LGBT- personat, personat e sëmurë me sëmundje të rralla dhe personat që jetojnë me diabet. Propozojmë të gjitha masat e propozuara të zbatohen nëpërmjet

përfshirjes përkatëse të organizatave qytetare relevante të cilat punojnë për mbrojtjen e të drejtave shëndetësore të qytetarëve, duke i respektuar parimet e shpërndarjes së të gjitha mjeteve buxhetore në dispozicion, të cilat do të përdoren në mënyrë efektive dhe efikase, dhe do të shpenzohen në tërësi, dhe nuk do të ri destinohen për aktivitete të tjera. Planifikimi dhe realizimi i buxhetit shëndetësor duhet të bazohet mbi respektimin e parimeve të jo diskriminimit dhe qasjes së barabartë drejt shërbimeve shëndetësore për të gjithë, si dhe rritjen e tij në mënyrë progresive.

Masat e propozuara vlejné për periudhën kohore prej 3,6,9 dhe 12 muaj.

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|--|---|---|--------------|
| 1. | Përfshirja e organizatave qytetare si ofrues të shërbimeve të caktuara shëndetësore | <ul style="list-style-type: none"> Rregullim ligjor i mundësisë organizatat qytetare të mund të ofrojnë shërbime të caktuara shëndetësore (për shembull, shërbimet të cilat deri tani i kanë siguruar OQ-të, sipas programit HIV/SIDA) në Ligjin për mbrojtje shëndetësore. | Ministria e Shëndetësisë MSH | 3 |
| 2. | Sigurimi i kuadrit përkatës profesional për dhënien e mbrojtjes shëndetësore primare | <ul style="list-style-type: none"> Rishikim i vendosjes së rrjetit të institucioneve shëndetësore për mbrojtjen shëndetësore primare dhe përkufizimin e saj në nivel të komunës (në vend të vendosjes së deritanishme në nivel të më shumë komunave respektivisht rajoneve). | MSH. | 3 |
| 3. | Avancimi i diagnostikimit të sëmundjeve | <ul style="list-style-type: none"> Furnizim i rregullt i reagjensëve për të gjitha procedurat e diagnostikimit të cilat mbulohen nga FSSH, në mënyrë përkatëse me nevojat e pacientëve. Mundësia për diagnostikim të sëmundjeve në vende të huaja, në rast të sëmundjes që nuk mund të diagnostikohet në vend, në periudhë prej gjashtë muaj. | MSH, Fondi i Sigurimit Shëndetësor të Maqedonisë (FSSHM). | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Zgjerimi i shërbimeve shëndetësore të cilat sigurohen në Programin për kontrolle sistimore të nxënësve dhe studentëve (për shembull, kontroll e enzimave hepatale të cilat mund të rezultojnë me zbulimin e hershëm të një sërë sëmundjeve). | MSH | 9 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|---|---|-----------------------------|--------------|
| 4. | Avancimi i shëndetit të grave | <ul style="list-style-type: none"> • Revizion i Ligjit për ndërprerjen e shtatzënisë në pajtim me udhëzimet e OBSH, me qëllim të mundësohet shërbim shëndetësor i pa penguar dhe cilësor. • Përforcimi i shërbimit patronazh nëpërmjet përgatitjes dhe miratimit të Rregullores për shërbimin patronazh, rritjen e resurseve njerëzore dhe resurseve teknike, edukim dhe ngjashëm. • Rregullim ligjor i mundësisë gjinekologët e institucioneve shëndetësore publike dhe institucioneve shëndetësore private, të cilët nuk kanë lidhur marrëveshje me FSSHM, të mund të punojnë si gjinekologë të autorizuar të zgjedhur (të përcaktojnë receta dhe të japin udhëzime për diagnostikim dhe për kurim të mëtutjeshëm) në komunat ku nuk ka gjinekolog të zgjedhur. | MSH, FSSHM | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> • Subvencionimi i specializimit për gjinekologë të cilët do të kenë obligim të punojnë si gjinekolog të zgjedhur në komunat ku nuk ka aspak gjinekologë amë. • Përpilim dhe miratim i protokolleve për skringing të sëmundjeve malinje, me theks të veçantë të skringut të kancerit të gjirit dhe kancerit në qafën e mitrës. • Vendosja e masave stimulative për gjinekologët e zgjedhur amë, siç është rritja e kapitacionit dhe kuotës së pacientëve amë për gjinekolog të zgjedhur. | MSH, FSSHM | 9 |
| 5. | Avancimi i shëndetit të pacientëve të cilët jetojnë me diabet | <ul style="list-style-type: none"> • Shfuqizimi i Komisionit nacional për diabetes melitus. | MSH. | 3 |

| Nr. ren. | Prioritetet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|--|---|-----------------------------------|--------------|
| 6. | Avancimi i shëndetit të personave që jetojnë me HIV/SIDË | <ul style="list-style-type: none"> • Sigurimi i buxhetit për realizimin e Programit HIV/SIDA për vitin 2018 në shumë prej 100.000.000 denarë | MSH. | 3 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> • Përpilimi dhe miratimi i Strategjisë për HIV/ SIDË për periudhën 2017 - 2021 dhe alkimi i mjeteve financiare përkatëse nga buxheti nacional. • Azhurnimi i barnave të regjistruara për HIV/SIDË për periudhë prej gjashtë muaj. | MSH, FSSHM dhe Agjencia e Barnave | 6 |
| 7. | Avancimi i qasjes drejt barnave | <ul style="list-style-type: none"> • Rishikimi i listës pozitive të barnave dhe mjeteve ndihmëse ortopedike dhe mjeteve të tjera ndihmëse të FSSHM në drejtim të: Vendosijes të së paku një ilaçi për shërimin e të gjitha diagnozave për të cilat ekziston terapi, vendosja e barnave inovative, vendosja e ushqimit special dhe suplementë të tjerë, mjete ndihmëse ortopedike etj. | MSH, FSSHM | 6 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> • Rishikimi i Ligjit për furnizime publike në lidhje me furnizimin e barnave dhe materialeve mjekësore, respektivisht të rishikohen dispozitat në lidhje me Këshillimin e furnizimeve publike, minimum standarde për cilësi, dokumentacioni i tenderit, mënyra dhe zgjedhja e personave profesional në Këshillin për Furnizime Publike, përkufizimi i rolit të Agjencisë për Barna në këto procese etj. • Anulimi i kuotave për barna ç[r barnatoret, me qëllim të mundësohet barnat që janë përshkruar me recetë të jenë të qasshme në të gjitha barnatoret që kanë marrëveshje me FSSHM. • Vendosija e barnatoreve kujdestare në komunitat ku nuk janë prezent. • Ndryshim i rregullativës ligjore për përdorimin mjekësor të kanabisit, në mënyrë përkatëse me mangësitë e përcaktuara nga praktika e deritanishme. | Ministria e Financave (MF), FSSHM | 9 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|------------|--|--|--|--------------|
| | | <ul style="list-style-type: none"> Planifikim, furnizim dhe shpërndarje e barnave në institucionet shëndetësore spitalore, në mënyrë përkatëse me numrin e regjistruar të pacientëve. | Institucione spitalore publike - shëndetësore, MSH, FSSHM | 12 |
| 8. | Planifikim përkatës dhe buxhetim i programeve të Ministrisë së Shëndetësisë në nivel më shumë vjetor | <ul style="list-style-type: none"> Përpilimi i të gjitha programeve të cilat i zbaton Ministria e Shëndetësisë, në mënyrë përkatëse me nevojat e planit afatmesëm (3 vjet), me llokim përkatës buxhetor. | MSH | 6 |
| 9. | Miratimi dhe buxhetimi i politikave shëndetësore | <ul style="list-style-type: none"> Miratimi i plan veprimeve të parashikuara me Strategjinë shëndetësore të RM-së 2020 dhe përfshirja e organizatave qytetare dhe shoqatave të pacientëve në proceset e planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit, nëpërmjet publikimit të shpalljeve për procesin e konsultimit. | MSH | 6 |
| | | <ul style="list-style-type: none"> Rishikimi i protokolleve ekzistuese dhe miratimin e protokolleve të reja për diagnostikim dhe trajtim të sëmundjeve, në pajtim me mjekësinë e bazuar në prova dhe arritjet më të reja në medicinë, të përshtatura me kontekstin nacional. Rishikimi i Strategjisë për kujdes palijativ dhe shpërndarje të mjeteve buxhetore për realizimin e saj. | MSH | 12 |
| 10. | Avancimi i shëndetit të romëve | <ul style="list-style-type: none"> Parashikim ligjor i ndërmjetësuesve shëndetësor rom në sistemin e mbrojtjes shëndetësore dhe punësimin e tyre. Azhurnim dhe buxhetim përkatës të Plan veprimit nacional për shëndetin e romëve. | MSH në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale (MPPS) (në lidhje me propozim masën e dytë) | 6 |

| Nr. ren. | Prioritetet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|---|---|-----------------------------|--------------|
| 11. | Avancimi i shëndetit të personave përdorues të drogës | <ul style="list-style-type: none"> • Rregullimi ligjor i mundësisë organizata qytetare të shpërndajnë dhe administrojnë "Nalokson" në Ligjin për mbrojtje shëndetësore • Fillimi i procesit të përpilimit të Strategjisë për parandalim dhe trajtim të Hepatit C. • Përpilimi dhe miratimi i protokollit për trajtim të personave të mitur (nën 16 vjeç) vartës të drogës. • Përpilimi i Plan veprimit për drogë në Republikën e Maqedonisë 2018 - 2020 dhe përfshirjen në programet për reduktimin e dëmeve në suazat e të njëjtit. | MSH | 6 |
| 12. | Avancimi i shëndetit të pacientëve me sëmundje të rralla | <ul style="list-style-type: none"> • Përpilimi dhe miratimi i Plan veprimit më shumë vjeçar për sëmundje të rralla dhe sigurimi i mjeteve buxhetore për realizimin e tij. | MSH | 6 |
| 13. | Mundësimi i sigurimit shëndetësor për të gjithë qytetarët në RM | <ul style="list-style-type: none"> • Mundësimi i sigurimit shëndetësor dhe shfrytëzimi i mbrojtjes shëndetësore për personat të cilët nuk kanë dokumente personale. • Rishikimi i kriterëve për shumën e të ardhurave si kusht për sigurim shëndetësor pa pagesë për persona pa punë. • Shkurtimi i afatit të parashikuar për shfrytëzimin e sigurimit shëndetësor pa pagesë pas pushimit të marrëdhënies së punës. • Anulimi i kushtit për vazhdimësi në sigurimin shëndetësor prej 6 muaj, si kusht për shfrytëzimin e mjeteve ndihmëse ortopedike dhe pushimit mjekësor në barë të FSSH. | MSH, FSSHM, MPPS | 9 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|--|--|--|--------------|
| 14. | Avancimi i shëndetit të trans personave | <ul style="list-style-type: none"> Miratimi i standardeve dhe protokolleve për trans - persona, trajnim i kuadrit shëndetësor për trajtimin e trans - personave dhe sigurimin e shërimit në vende të huaja për trans - persona nëpërmjet FSSHM. | MSH, FSSHM | 9 |
| 15. | Vlerësim i gjendjeve në lidhje me indikatorët për vdekshmërinë e foshnjave të sapolindura, foshnjave që pinë gjë dhe vdekshmërinë perinatale | <ul style="list-style-type: none"> Zbatimi i hulumtimit i aplikueshëm në praktikë për shkaqet e këtyre gjendjeve. | MSH, Instituti i Shëndetit Publik | 12 |
| 16. | Avancimi i mënyrës së mbajtjes dhe përdorimit të statistikës shëndetësore | <ul style="list-style-type: none"> Parashikimi i obligimit ligjor për mbajtjen e statistikës shëndetësore me të dhëna të desegreguara (sipas moshës, gjinisë, përkatësisë etnike, popullatës urbane dhe rurale, rajonit etj.) në Ligjin për evidencë në shëndetësi. Parashikimi i obligimit ligjor Ministria dhe institucionet të tjera kompetente të përpilojnë hulumtime, të zbatueshme në praktikë, në veçanti për trendet e rëndësishme shëndetësore dhe indikatorët në Ligjin për mbrojtje shëndetësore dhe Ligjin për evidencë në shëndetësi. Vendosja dhe azhurnimi i rregullt i regjistrit të pacientëve me sëmundje kronike (me theks të veçantë te sëmundjet malinje, sëmundjet e rralla, sëmundjet jo ngjitëse progresive kronike dhe sëmundjet ngjitëse kronike). | MSH; Instituti për Shëndet Publik ISHP (institucione shëndetësore publike) dhe Enti Shtetëror për Statistikë | 12 |

| Nr. ren. | Prioritet | Masa | Institucioni/et kompetent/e | Afati (muaj) |
|----------|---|---|-----------------------------|--------------|
| 17. | Avancimi i mekanizmave për mbrojtjen e zbatimit të të drejtave shëndetësore | <ul style="list-style-type: none"> • Vendosja e të gjitha mekanizmave të përcaktuara ligjore për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve. • Ndërmarrja e të gjitha masave të nevojshme për veprimin në kohë dhe përkatës të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të FSSHM për mbrojtjen e të drejtave shëndetësore të qytetarëve. • Ndërmarrja e të gjitha masave të nevojshme për respektimin e vendimeve gjyqësore të miratuara nga gjykatat administrative në kontestet nga fusha e shëndetësisë. | Qeveria e RM-së | 12 |

LISTA E SHKURTESAVE TË PËRDORURA

| | |
|------------------|--|
| APRM | Agjencia për Punësim e Republikës së Maqedonisë |
| SAIMLGj | Sistem i automatizuar informativ për menaxhim me lëndë gjyqësore |
| ARS | Agjencia për të Rinj dhe Sport |
| AK | Agjencia për Kundërzbulim |
| AGJPP | Akademia për Gjykatës dhe Prokuror Publik |
| AMFBZHR | Agjencia për Mbështetje Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural |
| BFP | Byroja për Furnizime Publike |
| BZHA | Byroja për Zhvillimin e Arsimit |
| OBRM | Organizata e Brendshme Revolucionare maqedonase |
| AL | Arsimi i lartë |
| QRM | Qeveria e Republikës së Maqedonisë |
| OQ | Organizata Qytetare |
| TVSH | Tatimi mbi vlerën e shtuar |
| ESHR | Enti Shtetëror i Revizionit |
| ESHS | Enti Shtetëror i Statistikës |
| KSHZ | Komisioni Shtetëror Zgjedhor |
| QSHP | Qendra Shtetërore e Provimeve |
| KSHPK | Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit |
| ISHA | Inspektorati Shtetëror i Arsimit |
| USHT | Universiteti Shtetëror i Tetovës |
| KE | Komisioni Evropian |
| ELEM-CEM | Centralet elektrike të Maqedonisë |
| NJVL | Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale |
| RVENRR RM | Regjistri i Vetëm Elektronik Nacional i Rregullave të Republikës së Maqedonisë |
| BE | Bashkimi Evropian |
| LNA | Ligji për Nëpunës Administrativ |
| LSHQF | Ligji për Shoqata të Qytetarëve dhe Fondacione |

| | |
|----------------------|---|
| LSHF | Ligji për shoqata dhe fondacione |
| LPP | Ligji për Procedurë penale |
| LPPA | Ligji për procedurë të përgjithshme administrative |
| EPS | Enti për Punë Sociale |
| KZGJ | Kodi zgjedhor |
| IPA | Instrument për Ndihmë Aderuese |
| ISHP | Institucion Shëndetësor Publik |
| PP | Prokurori Publike |
| PPNKOK | Prokurori publike për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit |
| PPRM | Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë |
| NP | Ndërmarrje publike |
| KÇE | Komisioni për Çështje Evropiane |
| KMDQLIKP | Komisioni për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë drejt Informatave me Karakter Publik |
| KRL | Këshilli Rinor Lokal |
| ASHAM | Akademia e Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë |
| ASSPFK | Agjencia për Supervizion të Sigurimit Pensional me Financim Kapital |
| MPB | Ministria e Punëve të Brendshme |
| ME | Ministria e Ekonomisë |
| MEPSO (OSEPM) | Operatori i sistemit elektro përçues - maqedonas |
| MMJPH | Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor |
| MSH | Ministria e Shëndetësisë |
| MBPEU | Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë Ujore |
| MSHIA | Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë |
| MK | Ministria e Kulturës |
| MASH | Ministria e Arsimit dhe Shkencës |
| MM | Ministria e Mbrojtjes |
| MD | Ministria e Drejtësisë |
| MTL | Ministria e Transportit dhe Lidhjeve |

| | |
|---------------|---|
| MPPS | Ministria e Punës dhe Politikës Sociale |
| MF | Ministria e Financave |
| BPRM | Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë |
| KRNM | Këshilli Rinor Nacional i Maqedonisë |
| KNEI | Këshilli Nacional për Euro Integritim |
| KAE | Këshilli për Akreditim dhe Evaluim |
| OSBE | Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë |
| VNMJ | Vlerësim për Ndikimin mbi mjedisin jetësor |
| ZIDDNJ | Zyra e institucioneve demokratike dhe të drejtave të njeriut |
| OASH | Organe të administratës shtetërore |
| OBEZH | Organizata për bashkëpunim ekonomik dhe zhvillim |
| BRE | Burime ripërtëritëse të energjisë |
| PPTH | Prokuroria Publike Themelore |
| KB | Kombet e Bashkuara |
| GJTH | Gjykata Themelore |
| FSPIM | Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Republikës së Maqedonisë |
| ZRRBP | Zyra rajonale për të rinj të Ballkanit Perëndimor |
| KRE | Komisioni Rregullator i Energjetikës |
| RM | Republika e Maqedonisë |
| SHBA | Shtetet e Bashkuara të Amerikës |
| SIMKO | Sekretariati për Implementimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit |
| PSP | Prokuroria Speciale Publike |
| VSMJ | Vlerësim strategjik i mjedisit jetësor |
| PIMS | Projekt për implementimin e mbrojtjes sociale |
| ASP | Asistencë sociale me para |
| DSK | Drejtoria për Siguri dhe Kundërzbulim |
| UGD | Universiteti "Goce Dellçev" |
| DAP | Drejtoria e të Ardhurave Publike |
| UKM | Universiteti "Shën Cirili dhe Metodi" |
| UKO | Universiteti "Shën Kliment Ohridski" |

| | |
|----------------|---|
| DAAGJPB | Drejtoria për Avancimin e arsimit të në gjuhët e pjesëtarëve të bashkësive etnike |
| FSSHM | Fondi i Sigurimit Shëndetësor të Maqedonisë |
| RQRM | Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë |
| QPS | Qendra për Punë Sociale |
| QAMPT | Qendra për Arsim të Mesëm Profesional dhe Trajnim |
| SFQLM | Spektori për Financim Qendror dhe Lidhjen e Marrëveshjeve |

SHTOJCA 1 – LISTA E ORGANIZATAVE DHE EKSPERTËVE TË PËRFSHIRË NË INOVACIONIN

(me * janë shënuar organizatat dhe ekspertët të cilët janë përfshirë vetëm në përpilimin e dokumentit “Propozim për reforma demokratike urgjente” në korrik 2016)

Lufta kundër korrupsionit

- Instituti për demokraci “Societas civilis”- Shkup
- Koalicioni “Të gjithë për gjykim të drejtë”
- Fondacioni Shoqëri e Hapur – Maqedoni
- Qendra për Hulumtime dhe Krijimin e Politikave
- Transparensi Interneshënëll – Maqedoni
- Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar
- *Transparencë Maqedoni

Shoqëria qytetare

- Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Qytetare
- Evrotink – Qendra për Strategji Evropiane
- Shoqata “Konekt”
- Shoqata “Federalistë të rinj Evropian” – XHEF Maqedonia
- Forumi Arsimor Rinor
- Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar
- Këshilli Rinor Nacional
- Këshilli Nacional për Barazi Gjinore
- Reaktor – Hulumtim në Veprim
- Fondacioni OJQ Infocentar
- Fondacioni Shoqëri e Hapur – Maqedoni
- Fondacioni për Zhvillim Lokal dhe Demokraci “Fokus”
- Qendra për Arte Moderne – Shkup

Mjedisi Jetësor dhe energjetika

- Analitika think-tenk
- Asociacioni për mjedis të pastër „AJDE MAQEDONI“
- *Eko Gerila
- Shoqata e qytetarëve për zhvillim të qëndrueshëm të mjedisit jetësor “Bëhu i gjelbër“
- *Shoqata e qytetarëve “Front 21/42“
- Qendra për hulumtim dhe informim për mjedisin jetësor “Eko – svest“
- Shoqata Ekologjike Maqedonase
- Mileukontakt Maqedoni
- Gazetarë për të drejtat e njeriut
- ORT – trajnim për zhvillim të qëndrueshëm
- *Ohrid SOS
- Qendra për strategji dhe zhvillim “Paktis” – Prilep
- CNVP Fondacioni – Maqedoni

Shëndetësi

- Shoqata e qytetarëve me sëmundje të rralla “Jetë me sfida“
- Shoqata për emancipim, solidaritet dhe barazi të grave – ECE
- Shoqata “Së bashku më të fuqishëm“
- Iniciativa për zhvillim dhe inkluzion të komuniteteve – IRIZ
- Koalicioni “Të drejta seksuale dhe shëndetësore të komuniteteve të marginalizuara“
- Organizata e romëve për afirmim multikulturor ROMA SOS
- Fondacioni Shoqëri e Hapur – Maqedoni
- HAE Maqedonia
- Asociacioni për edukim shëndetësor dhe hulumtim – HERA
- Shoqata HOPS – Opsione për jetë të shëndetshme
- Shoqata e personave me diabet „Sheqerçe – Lilipop“ Veles

Zgjedhje dhe sistemi zgjedhor

- Shoqata për promovim dhe zhvillim të shoqërisë inkluzive INKLUZIVA
- OJQ KHAM – Dellçevë
- Shoqata “Federalistë të rinj Evropian” – XHEF Maqedonia
- Shoqata qytetare MOST
- Shoqata qytetare “Proficio“
- Qendra për Zhvillim të Qëndrueshëm të Komunitetit Dibër
- CIVIL – Qendra për Liri
- Aleksandar Stojanovski

Administrata publike

- Asociacioni për iniciativa zhvillimore ZENIT
- Shoqata për Zhvillim Lokal Aksion plus, Resnjë
- Evrotink – Qendra për Strategji Evropiane
- Institut për Politikë Evropiane
- Fondacioni Shoqëri e Hapur – Maqedoni
- Qendra për Menaxhim me Ndryshime
- Dragan Gocevski
- Metodija Dimovski
- *Branimir Jovanoviq

Financa publike dhe ekonomi

- Analitikë tink – tenk
- Shoqata për emancipim, solidaritet dhe barazi të grave – ECE
- Qendra për Analiza Ekonomike
- Qendra për Zhvillim të Qëndrueshëm të Komunitetit – Dibër
- *Shoqata e Analistëve të Rinj dhe Hulumtuesve
- *Branimir Jovanoviq
- *Petar Gjoshev
- *Nikolla Popovski
- *Goran Petrevski
- *Abdylmenaf Bexheti

Kontrolli mbi policinë dhe Agjencitë për Siguri dhe (Kundër)Zbulim

- Analitikë tink – tenk
- Asociacioni për iniciativa zhvillimore ZENIT
- Evrotink – Qendra për Strategji Evropiane
- Forum për Hulumtimin e Politikave të Sigurisë “Sekuritas”
- FORUM- Qendra për Hulumtime Strategjike dhe dokumentacion
- Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë
- Trpe Stojanovski
- *Gordan Kalajxhiev

Drejtësia

- Institut për Politikë Evropiane
- Institut për të Drejtat e Njeriut - Shkup
- Koalicioni "Të gjithë për gjykim të drejtë"
- Shoqata Maqedonase e Juristëve të rinj
- Organizata e romëve për afirmim multikulturor ROMA SOS
- Fondacioni Shoqëri e Hapur - Maqedoni
- Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë
- Qendra për hulumtime juridike dhe analiza

Arsim dhe politika rinore

- Shoqata e qytetarëve për zhvillim të qëndrueshëm të mjedisit jetësor "Bëhu i gjelbër"
- Shoqata e pedagogëve të Qytetit Shkup "Pedagog bashkëkohor"
- Shoqata "Federalistë të rinj Evropian" - Maqedonia
- Iniciativa për zhvillim dhe inkluzion të komuniteteve - IRIZ
- Qendra Kulturore Rinore - Manastir
- Forumi Arsimor Rinor
- Plenumi arsimor
- Këshilli Rinor Nacional
- Sindikata e pavarur akademike
- Miqtë e arsimit
- Fondacioni për Iniciativa arsimore dhe kulturore "Hap pas hapi"- Shkup
- Fondacioni Shoqëri e Hapur - Maqedoni
- Fondacioni për Zhvillim Lokal dhe Demokraci "Fokus"
- Qendra për tolerancë ndër etnike dhe refugjatë
- Qendra për mbështetje arsimore të fëmijëve "Dendi vas"
- Qendra për komunitetin e Komunës Qendër
- Nikolla Levkov

Kulturë

- Vizioni qendër për fata - shkencë në Maqedoni
- Qendra teatrore për fëmijë - Shkup
- Iniciativa për aktivizëm të pavarur kulturor - INKA
- JADRO - Asociacioni për skenë të pavarur kulturore
- Koalicioni "Të drejta seksuale dhe shëndetësore të komuniteteve të marginalizuara"

- KONTRAPUNKT – asociacioni për zhvillimin e teorisë kritike, aktivizmit socio - kulturor dhe praktikave moderne artistike
- Qendra për bashkëpunim ballkanik “Loja”
- LOKOMOTIVA – Qendra për iniciativa të reja në art dhe kulturë
- Shoqata e artistëve Qendra Kulturore “Mediaartes” - Ohër
- Forumi Arsivor Rinor
- Shoqata “Multimedija”
- Organizata për aktivizëm, teori dhe art “Sheshi Liria”
- “Pres tu egzit” hapësirë për projekt
- Strit qendra e Maqedonisë
- Fakultet për punë që nuk mësohen
- Fondacioni Shoqëri e Hapur - Maqedoni
- Qendra për Arte Moderne - Shkup
- Oliver Musoviq
- Gjorgje Jovanoviq
- Velimir Zhernovski
- Nikolla Gelevski

Kuvend

- Instituti për demokraci “Societas civilis”- Shkup
- Fondacioni Shoqëri e Hapur - Maqedoni
- Shoqata qytetare MOST

Mbrojtje sociale, mirëqenie dhe qëndrueshmëri

- OJQ KHAM – Dellçevë
- Platforma maqedonase kundër varfërisë
- Reaktor – Hulumtim në Veprim
- Shoqata HOPS – Opsione për jetë të shëndetshme
- “Publik” asociacioni për hulumtim, komunikime dhe zhvillim
- Asociacioni për edukim shëndetësor dhe hulumtim - HERA
- Shoqata “Humanizëm”
- Shoqata “Justicija” – Kumanovë
- SOS Fshati i fëmijëve Maqedoni
- *Marjan Nikollov
- *Dragan Gocevski
- *Branimir Jovanoviq

